



LSHSHM - SHKUP

SPAM - SKOPJE

AAWM - SKOPJE

NETËT POETIKE TË DIMRIT MADH XXV

DUKE E PERCJELLUR KORONAVIRUSIN

Shkup: me 29, 30 dhe 31 dhjetor 2020.

TAKIME NËN RRAP

(XXV)

Në vend të parathënies

TË LEXOSH POEZI PRANË TANKEVE

Një reportazh emocional nga Shkupi

Rruga drejt Shkupit me atobusin me targë TR pati shumë ndalesa dhe kontrole të herëpashershme. Ushtarë të veshur me të blertën laramane të luftës kërkonin pasaportat, kontrollonin bagazhet dhe donin të dinin ç'ishim...

E nesërmja do të fillonte me debatin “Poezia erotike”. Pse debat, thosha unë, mjaftë me to, por me harmonizim idesh. Folën N. Vinca, S. Bejko, N. Lako, Xh. Limani, J. Papingji, e të tjerë që s'duronin pa lexuar poezi dashurie. Fituesit u ftuan të lexojnë prapë poezi. Qeli, 1997, kur vriteshin poetët, do të recitonte Xhevahir Spahiu. Ka filluar më herët vrasja e poetëve, do të shtonte Faruk Myrtaj. Mikrofoni gjëmonte si jehonë granatash...

Kështu na ndodhi vërtet, lexuam poezitë tona pranë tankeve në Shkup. Netët poetike të verës “**Takime nën Rrap**” që i organizon çdo vit Shoqata e Shkrimtarëve Shqiptarë atje, na mblodhi tani, në vjeshtën e dytë, përshkak të luftës, natyrisht, kjo vonesë.

Autobusi me poetë u nis në mëngjes nga Tirana, duke i rënë më gjatë, jo nga Kërraba, sepse një urë s'e mbante dot peshën (kemi kohë që ecim kështu, kudo ku s'na mbajnë dot) dhe, ndërsa shihnim rrugën ku qe zgjëruar dhe ndrequr mirë, i vërsuleshim shoferit me lëvdata për shtetin. Gropa prapë dhe pluhur, unaza të tmerrshme qytetesh të rrëgjuar, që ngjanin me rrathët e shtrembër të Ferrit dhe shtylla me postera të grisura deputetësh a keqbërësish në kërkim. Ndoshta njëlloj janë.

Pasi lamë anash në pak mjegull pasqyrën lasgushiane të liqenit, mbërritëm në kufi. Po ajo ngrëhinë e palyer e jona, mureprishur, e varfër. Ndërsa vulosnim pasaportat, u ngrit trari i kuq i postbllokut, sikur të qe zgjuar një vetëtimë e plakur, dembele. Dolëm përmatanë, te gjuha tjetër. Pranim keqkuptime, por përkundrazi. “Poetë”, pyeti policja maqedonase, duke parë një listë emrash mbi tryezën e saj, “kaloni”, tha anglisht dhe në gjuhën e saj. Si gjithmonë Pano Taçi po bënte gallatë me taksistët shqiptarë të Maqedonisë. Ndërsa regjistronte kamerën e tij në doganë.

Rruga drejt Shkupit me autobusin me targë TR pati shumë ndalesa dhe kontrole të herëpashërshme. Ushtarë të veshur me të blertën laramane të luftës kërkonin pasaportat, kontrollonin bagazhet dhe donin të dinin ç’ishim.

“Bashkë... kolektiv... poetë”, sqaronim ne me zë të lartë. Dikush tregonte dhe ftesën. Automatikët e vegjël dhe të zinj në duar të ushtarakëve sikur tërhiqeshin paksa e mua më pëlqente të mendoja se poezia, në fund të fundit, i mposht armët.

Ndalëm sa për të pirë një kafe në Strugën e liqenit, në bregun e së cilës, atje ku vendosa të haja më këmbë bukën që kisha marrë me vete, m’u mblodhën mjellmat e bardha, mahnitëse. Zgjasnin qafat, aq shumë poetike dhe donin t’u jepja diçka. Sqepat e artë, gjithë gu-gu-gu e kafshime të ëmbëla, më rrëmbenin copa buke e biskotash. Merrini, se një mjellmë e bukur sa ju, m’i ka dhënë, u thosha. “Ja, ky është elektorati yt”, thirri buzagas Faruk Myrtaj, ndërsa u ndje shkrepëtima e një blici pranë.

Përsëri rrugë, male, pyje dhe vetmia jonë drithëronjëse në muzgun që po binte me shpejtësi. Asnjë makinë tjetër si në shtetrrethime. Xhevahir Spahiu një dritare më përpara, si një strateg, na i tregonte mallet hijerëndë, emrat e tyre, grykat

historike, lumin Drin, betejat, prushuritjen e Dibrës, vendet e UÇK - së. Ai e do Atdheun kudo, me atë pasion si Skraparin e tij, mërmërita. Vonë dolëm në autostradë. Kontrolle prapë, polici, armë, tanka të mbuluar me rrjeta që imitonin barin dhe natyrën si xhinda të verbëra. Gostivar. Heshtje. Tetovë. Ankth. Ku është Universiteti shqiptar? Po shtëpitë e poetëve Murat Isaku, Adylazis Islami? Në hyrje të Shkupit, ata që na prisnin, na udhëhoqën për në hotelin “Saraj”, pranë lumit Vardar dhe pyllit brenda territ maqedonas.

Megjithëse mbërritëm shqetësueshmërisht vonë, veprimtaria pa vëllezërit nga Tirana, s’kish si të fillonte. Kryetari i Komunës së Sarajit (ka shumë shqiptarë këtu, prandaj zgjodhëm këtë vend, për siguri, na thane), “shtroi sofrën poetike”. Nisi ora simbolike letrare. Aktori i shquar Xhevat Limani recitoi në mënyrë Shekspirane Asdrenin. Zëri i tij kushtrimtar trondiste sallën: **Nuk duam gjë tjetër, nukë/vetëm ca armë dhe ca bukë**. Recituan poetët nga të gjitha trevat poezitë e tyre, por edhe të miqve. Kishte autorë që s’jetonin më, por edhe të ikur me UÇK - në maleve e s’mund të merrnin dot pjesë. Grupi i këngëtarve “Okarina” nga Shkupi e emocionoi gjendjen me këngë të famshme shqiptare. Kalosh Çeliku, kryetari i Shoqatës së Shkrimtarëve, nuk e fshihte shqetësimin e vet, endej nëpër holl dhe koridoreve edhe pas mesnatës. Do të flinte i fundit, se mos ndodh gjë. Mos bëni shëtitje të largëta porosiste, sidomos vetëm, janë patrullat.

E nesërmja do të fillonte me debatin “Poezia erotike”. Pse debat, thosha unë, mjaftë me to, por me harmonizim idesh. Folën Nuhi Vinca, Sadik Bejko, Natasha Lako, Xhevat Limani, Jorgo Papingji, e të tjerë që s’duronin pa lexuar poezi dashurie. Pano Taçi ja futi me pornografi. Pastaj u shpërndanë nëpër shkolla. Po një shëtitje nëpër Shkup?

Patjetër, patjetër, ditën s'ka rrezik, na thanë. Desha të shoh shtatoren e Nënë Terezës. Aktori Xhevat Limani, dashamirës si gjithmonë, i cili sapo kishte botuar dhe një libër me pozi "Pranverë dimërore", ka të drejtë për këtë titull, na çoi me veturën e vet, herë pranë një xhamije e pastaj një kishe, bulevardë të gjëra, vitrazhe, rini. Ndalëm te memoriali, ku kishte qenë shtëpia e shenjtores tonë, Nënë Tereza. Një pllakë mes luleve në anglisht dhe maqedonisht. Po në gjuhën e saj, në shqipen e lashtë? Ishte këtu, mbi trotuar, por ia thyen gerrat dhe e hoqën. Menjëherë m'u kujtua parathënia e librit tim me poezi, i porsa botuar në maqedonisht, ku poeti Ante Popovski, mes lëvdatave, shkruan një paragraf sikur shqiptarët tani janë ngritur me armë kundër gjuhës maqedonase. Kurse te shtatorja e Nënë Terezës, e cila vinte ca e lëmuar, pa ato rrudhat e dhimbshme dhe në veshjen e saj, pa asnjë fjalë shqip përsëri, piva ujë te çezma e shenjtë. Mbi pedestal vezullonte një grumbull i vogël parash, denarë. Hudhëm dhe ne nga lekët tona të pakta. Pashë sërish fytyrën e saj të bronztë, duke u brengosur që në Tiranë ende s'ka asnjë statujë të sajën. Sa herë u kemi thënë ministrave të Kulturës që mund të vihej kudo e kudo një pllakëz memeri, ku të gdhendej shkrimi i saj në atë përhëndetjen shqip, shkruar me dorën edhe të Shenjtores tonë në ditën kur mori çmimin "Nobel" e na uronte dhe poshtë të vihej përkthimi anglisht. Pse Shqipëria zyrtare vazhdimisht e largon Nënë Terezën si një mirazh apo i trembet ballafaqimit laik me mëshirën e saj hyjnore, të pafundme? Ajo mëmërit, "duajeni njëri tjetrin" në vendin ku rrëmbejnë armët kundër njëri - tjetrit sipas porosisë së fantazmës së diktatorit.

Në mbrëmje filloi veprimtaria "*Me poezi e këngë deri në agim*", e cila u çel me përrurimin e revistës letrare "**Stili 97**", botim i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptarë në Maqedoni.


Recitonin poetë e poetesha, por jo gjithmonë vargje erotike, përkundrazi, më shumë zotëroi tema e të tanishmes tronditëse, flamuri, gjuha, trualli, indentiteti, mërgimi. U duartrokitën gjatë Musa Ramadani, Xhevahir Spahiu, Lulëzim Haziri, Linda Karadaku, të cilët u vlerësuan me çmime të ndryshme, por dhe Iliriana Sulkuqi, Pano Taçi, Skënder Rusi, Zyhdi Morava, Natasha Lako, Sadik Bejko, Shazim Mehmeti, Mirela Sula, Milianov Kallupi, Skënder Temali, Entela Safeti etj. e etj. Edhe Agim Xheku recitoi fuqishëm një poezi burgu timen për një vajzë që endej pas telave me gjemba. U lexuan dhe të munguarit Enver Hadri dhe Rexhep Bajrami, njëri në varr dhe tjetri maleve. Por ishte Qazim Shemaj ai, i dehur që shpotiste këdo, ndërhynte me zë, krijonte kundërsensin, një si shkundëllimë kundër mundësisë së banalitetit, duke shkatuar kështu gazmend ilegal, ndërsa gazetarja Rezarta Reçi mbante shënime. Kamera e televizionit vandas thithte pamje drite e sy poezish. Juria, me kryetar Nehas Sopajn, shpalli fitues për “veprën jetësore letrare”, shkrimtarin e shquar shkupian Resul Shabani. Për të cilin dhanë vlerësime dhe kolegë të tjerë. Herë pas here krijoheshin pauza të bukura ku kantautori nga Kërçova, Ferid Abdiu, me një zë, sa melodioz, po aq edhe ëndrrimtar këndonte shqip, vetëm shqip e tingujt e organos elektrike sikur krijonin shandanë kristali e qirimajtëse alabastri në ajër. Fituesit u ftuan të lexojnë prapë poezi. Qeli, 1997, kur vriteshin poetët, do të recitonte Xhevahir Spahiu. Ka filluar më heret vrasja e poetëve, do të shtonte Faruk Myrtaj. Mikrofonit gjëmonte si jehonë granatsh. Muzikë, vallzime, shëtitje nate nën hënën mes degëve të rrapeve, këngë të tjera, përsëri dhurime librash, autografe, urime për çmimet. Ç’është kjo, u thosha unë organizatorëve, çmimi II, III (!?), poezia ka çmim tjetër, veç bukurisë së vetvetes. Mos i jepni më, u gjeni

emra të tjerë si p.sh. Çmimi i Shkupit, i kësaj mbrëmje, i të rinjve etj.

Ke të drejtë, më përgjigjeshin. Mos u largoni shumë, dëgjoheshin porositë, jashtë janë tanket. Vërtet ne kishim lexuar poezitë tona pranë tankeve të shtetit maqedonas. I pamë në mëngjes, kur morëm rrugën e kthimit, në anë. Rrjesht i zi i metaltë, vrastar. Te kullat e çeliktat ushtarë me automatikë. Dhe mbi zingjirët, nën tytat e frikshme bënë shenjë të ndalte autobusi ynë. U fut një ushtar i ri. Me drojtje kërkoi kush kishte kamera, që sapo xhiroi nga xhamat. U fut dhe një ushtar tjetër i armatosur, bjond dhe i egër. Kamera, bërtiti. Mos kishte thënë kamarad? Pastaj erdhi një i tretë, i errët dhe inatçor, u vërsul nëpër ne, rrëmoi çantat me duart si qen dhe nxorri nga kamera e Pano Taçit përtej kasetën dhe u kthye vrik duke hunguruar maqedonisht. S'kam filmuar tanket, por poetë, u dëgjua britma pa dhëmbë e Panos së djersitur. Të gjithë u djersitëm. Na kishin grabitur vizionet, dëshminë e pafajshme të këngëve tona dhe e kaluam kufirin pa to. Heshtnim. Më pas gjëndjen e funeraltë e shtoi edhe më kumti i Zyhdi Moravës. Ja, aty në atë rrëpinë u pushkatuan dy poetët e Librazhdit. Kthyem kokat andej dhe pamë veç natë prej dheu si ajo e syve të pushkatuar. Në kujtim të tyre le të ushtojë buria. Ndjemë klithma përbrenda. Prapë rrugë dhe natë. **Të rashë pas, moj, të rashë pas**, nisi të tallazitet lehtë radioja e autobusit tonë. Sa breza u rritën vetëm me këtë këngë dashurie? A s'krijonte dot të tjera, populli im? Vetë e keni fajin, më tha një vajzë e re dhe buzëqeshi pa të keq. I pash buzët e enjtura. Me siguri ajo ishte puthur në Shkup...

Visar ZHITI

Tiranë, DITA 3 nëntor 2001



Adem Xheladini,

lindi në fshatin Zajaz të Kërçovës. Është, autor i disa librave me poezi dhe prozë. Njëkohësisht, edhe kryetar i Klubit të shkrimtarëve në Kërçovë. Organizator, edhe i Takime Poetike të Hyjneshës Thana, në Kërçovë.

Mallëngjim mërgimtarësh

E di... (mallëngjim mërgimtarësh)

Ti nuk ke pse më shan kur unë vij vonë pasdarke
Se rrugë e gjatë, më shpie për në strehën tënde
Edhe rrezet shpesh thyhen në të ylbereve harqe
Pranverës së parë kur zogjtë ia marrin një kënge

Unë zakonisht, vij vonë, më vonë se të tjerët,
Megjithatë, s'kam nge t'ik papritmas prej teje
Ndonëse i lodhur, në palcë nga zheg i verës,
Brenda teje të futem përmes një fije prej reje

E di, është dimër, dhe ti ke ftohtë aty ku buan,
E ndjej zërin e akullit të të thyhet, copë-copë,
Një botë tjetër, mbase në mendje më bluan,
Por, yjeve në qiell, ne s'u hapim dot një gropë

Ndaj, Ti mos u tremb, se megjithatë unë do të vij,
Atë natën ta shtrydhim gjer vonë në përgjërim
Atë zjarrin nga kohë të largëta aty ta përbijmë
Dhë ëndrrat t'i përqafojmë, në të parin ngashërim!

Kërçovë, korrik 2020



Asdren Çeliku lindi në vitin 1986 në Shkup. Shkollën fillore dhe gjimnazin i mbaroi në vendlindje, si dhe studimet e gjuhës dhe letërsisë shqiptare të cilat i kreu në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” në Fakultetin Filologjik “Blazhe Koneski”, në Shkup. Momentalisht, punon në Radio Televizionin e Maqedonisë, në Redaksinë e fëmijëve si udhëheqës emisionesh. Kohë pas kohe merret edhe me shkrime artistike dhe poezi të cilat i ka pasion prej moshës së hershme. Vazhdon të jetojë, punojë dhe të veprojë në Shkup.

Autori deri më tani ka publikuar këto libra artistik: *Mëngjeset janë parajsja* (poezi, 1999), *Qiellziu* (prozë, 2020). Dhe, ka rikënduar dhe përkthyer nga gjuha shqipe dhe anasjelltas në gjuhën maqedonase edhe librat: *Oqeani i grave* (poezi) - Marina Mijakovska, dhe *Pretenca* (roman), nga Istref Haxhillari.

Jeta

Do ta gjesh veten para një labirinti
Por rruga jote nuk do të jetë labirinti.

Përcilli hapat e atyre që të mësuat të ecësh
Dhe do ta gjesh rrugën e do ta kapësh ditën
Me fuqi hyjnore,
Sepse ashtu është të qenurit.

Mos nguro,
E di se jeta do të tentojë të të mësojë ndryshe,
Të të bëjë për vete,
Pastaj do të bëjë të ndjehesh vetëm;

Por ti e përballon këtë,
E shoh në sytë e tu,
Ndërsa të mbaj në duar.

Unë eca mjaft për ta njohur jetën,
Pasionin e saj;
E kam parë se si shkëlqen
Në sytë e njeriut.
Ti zemra ime,
Ti je me të vërtetë hyjnore.
Tash e shoh se sa e vlefshme je...

18 prill 2017



Behare Neziri është më se e qartë se për njeriun dhe dinamikën e jetës, botës reale dhe imagjinatës si dhe për koherencën e mirësisë dhe së keqes, arsyeja është bërë një fushë, e cila nëpërmjet ndjenjës dhe dijes, shfaq protestë mbi gjuhën e sundimit, e cila kohës i flet herë me portrete nga e kaluara e botës njerëzore e herë me natyrën e reales si e vetmja gjuhë,

që vë në lojë arsyen e mendimit, ku poezia bëhet armë, e cila fton drejtësi.

Autorja deri më tani botoi këto libra me poezi: *Në lulishten e dashurisë*, *Prush dashurie* etj.

ELEGJI E PUTHJES

Miliona sy na panë
Edhe pse nuk u trembëm kurrë
Kur mbi ne, gjethet ranë
E puthjet tona visheshin me nurë

Nga inati, filloi të bjerë shi
Kur puthja jonë, vazhdoi përsëri
Të shtrirë në barë mbetem, unë dhe ti
Dhe ata, që donin të kishin dashuri



Besnik Lena Lindi në Ladorisht të Strugës më 7 dhjetor të vitit 1954. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Strugë, ndërsa fakulltetin (shkollën e lartë) në Degën e Gjuhës Frengje, në Prishtinë. Tani punon si profesor i frëngjishtes në shkollën “Ashim Agushi” Ladorisht, Strugë, Maqedoni. Është marrë me krijimtari që në moshë të hershme dhe botoi në gazetat e njohura në Kosovë dhe në Maqedoni, si: gazeta e “Pionerit”, ”Rilindja”, ”Gëzimi“ dhe “Flaka e vëllazërimit”. Libri “*Shkëndijat e fëmijërisë*“ është libri i tij i parë për fëmijë, botuar në vitin 1996 në shtëpinë botuese Onufri në Elbasan. Përmbledhja e dytë për të rritur “*Kur perënditë vdesin në liqen*” u botua në vitin 1998 nga shtëpia botuese “Ars plus” Korçë. Përmbledhjen e tretë “*Ky pyll dhe ky ujë* “ e botoi Lidhja e Shkrimtarëve Shqiptar të Maqedonisë në vitin 2004, Shkup. Poezinë e ka ushqim shpirtëror, ndërsa kulturën dhe civilizimin frëng e mbjell tek publiku i gjerë në tërë teritorin e Maqedonisë. Shko nga të shkosh të gjithë rrugët të sjellin në Strugë!

Shiu ma lexon trishtimin tim

Bie shi si një roman i mërzitshëm
 Që e lexon me dhimbje koke,
 Konsumohen minutat dhimshëm
 Si nën kërcitje rrote.

Qan qielli nën dhimbje resh,
 Malli vetëtimën zhdruk nën sjetull,
 Shfryn kozmosi dufet e veta,
 Ndërsa mua shiu më rrjedh nën mjekër.



Beatrice Balliçi lindi më vitin 1950 në Elbasan. Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa studimet e larta, Dega Gjuhë e Letërsi Shqipe, në Institutin e Lartë Pedagogjik në Elbasan. Punon si mësuese në vendlindje. Është e njohur

kryesisht si poete. Shkruan vjersha për fëmijë dhe për të rritur. Betariçe Balliçi jeton në Elbasan. **Veprat letrare:** *Kush m'i fail manushaqet* (1972), *Kam bërë buqetë* (1976), *Moj e vogla, moj e mira* (1978), *Sa të dua Shqipëri* (1980), *Shota* (1985), *Fjalë duke ecur* (1987), *Harpa* (1996) etj.

A NA MJAFTON NJË SHEKULL, MIKU IM

Dua të jetoj me ty një shekull.
 Kështu siç jemi,
 Me shikimin përherë të ri
 Dhe shpirtin të gjërë sa natyra.
 Të fitojmë e të humbim,
 Të duam e të urrejmë,
 Të bëhemi zogj,
 Të bëhemi pemë,
 Të bëhemi dallgë dhe rërë.

Do të më japësh
 Dhe do të të jap në heshtje.
 Natyra diçka do të na marrë
 Dhe përsëri diçka do të na kthejë:
 Vetja jonë e shndërruar në të ardhme.
 Unë dua të bëj me ty shumë gjëra.
 A na mjafton një shekull i tërë?



Bujar Ganija - Plloshtani

në vitin 2002 nisi studimet për Drejtësi në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë, ndërkohë është tërësisht i tërhequr pas poezisë dhe filozofisë. Nëntor-Dhjetor 2005 publikon librin e parë me poezi: "*Heshtja e poetit*". Në Dhjetor 2005, si anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptarë të Maqedonisë, viziton Goethe Haus & Goethe

Museum & Ekspozitën Friedrich Schiller në Frankfurt/Main. Më 23 Shtator 2006 merr pjesë në manifestimin letrar "Portiku poetik" të Dibrës. Më 27 Nëntor 2006 reciton në një Orë letrare poezinë "Perëndimi i shpirtit" kushtuar ditës së Pavarësisë së Shqipërisë. Më 22 e 23 Qershor 2007, në bashkëpunim me Bashkinë e Rrethit të Sarandës, organizon dhe drejton edicionin e parë të manifestimit letrar mbarëkombëtar "Saranda - muza e poezisë", në Sarandë. Në Tetor 2007 themelon Shoqatën e artistëve "Pushkin" dhe zgjidhet kryetar i saj. Më 10 nëntor 2007 merr pjesë në Netët poetike "Takime nën Rrap", të organizuar në Shkup. I jepet çmimi "Për vepër erotike" botuar brenda dy takimeve. Në nëntor të po atij viti i publikohet libri poetik "*Nga regjia e shpirtit*". Po në nëntor 2007, Shoqata e artistëve "Pushkin" organizon dhe drejton edicionin e parë të manifestimit letrar "Poezia, art i fjalës". Në vitin 2008 boton librin me poezi të zgjedhura nga autorë të botës: "*Perla e poezisë botërore*".


Vjeshta

Vjeshtë me shi,
Mërzitje dhe muzikë.
Mërzitje në shi!
Më duhet t'ia vë një emër!
Po sa mërzitje fshehim ne?!

Vjeshtë me shi,
Rropatje me shi,
Ndihet në qytet.



Kryetari i LSHSHM -së Kalosh Çeliku përpara Shtëpisë së Lidhjes të Shkrimtarëve Shqiptar, në Shkup (1997).



Baki Ymeri lindi në Shipkovicë të Tetovës. Ka kryer studimet e larta për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, në Fakultetin Filozofik, pranë Universitetit të Kosovës, në Prishtinë (1969-73) dhe Bukuresht (1975). Është poet, përkthyes dhe publicist. Komunikon në disa gjuhë dhe është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të

Rumanisë dhe i disa shoqatave internacionale të gazetarëve. Autori deri më tani botoi këto libra: Nikta Stënesku: *Ekspozitë e të palindurve*, Rilindja, Prishtinë (1986), Anghel Dumbrëveanu: *Kënga e mullibardhës*, Flaka, Shkup (1986), Slavco Almëzhan: *Xhuxhmaxhixhët harruan të rriten*, Rilindja, Prishtinë (1989), Marin Soresku: *Eja të ta them një fjalë*, Rilindja, Prishtinë (1990), *Shqiptarët e Rumanisë* (monografi, koautor), Aza, Tetovë (1995) *Dardania, deliana*, Bukuresht (1999), *Zjarr i shenjt*, Klubi Letrar 94, Tetovë (2001), *Drita e Dardanisë*, Bukuresht (2004), *Rruga e ferrit për në Parajsë*, Bukuresht (2005), *Poema të mëndafshta* (TipoMoldova, Jash, 2011, *Poezi dashurie – “Asdreni”* (Shkup, 2015) etj. Jeton dhe krijon në Bukuresht, ku është redaktor i revistës “*Shqiptari*” dhe veprimtar i dalluar i Bashkësisë Kulturore të Shqiptarëve të Rumanisë dhe i Shoqatës së Miqësisë Rumuno – Shqiptare.

DUKE RENDUR PAS BUKURISË

Të pëlqen poezia?
 Më pyete.
 O, ç’përgjigje e bukur
 Defilon në bregun e mëngjër
 Të lumit tënd të lazduar!
 Si të mos më pëlqejë vallë

Erëtimi e ëmbël
E këtij trëndafili me gjemba?!



Plisbardhi, afër tij Klito Fundo, Kalosh Çeliku dhe Daniela Zissi gjatë Akademisë Përkujtimore të Babait të Letërsisë për fëmijë: Mehmedali Hoxha, në Strugë (1997).



Bardhyl Londo lindi në vitin 1948 në Përmet, Shqipëri. Studioi për gjuhë dhe letërsi në Universitetin e Tiranës. Pas mbarimit të fakultetit ai punoi për disa vite mësues në Përmet dhe më pas për gazetën letrare “Drita”. Për disa kohë ka qënë kryetar i “Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve” (LSHA). Krijmtaria e tij letrare

përfshin 8 vëllime me poezi si edhe disa romane. Është fitues i çmimit “Migjeni”.

Tituj të veprave: *Krisma dhe trëndafila (1975), Hapa në rrugë (1981), Emrin e ka dashuri (1984), Si ta qetësoj detin - roman (1988), Ditë njerëzore, Shën Shiu (2010), Jeta që na dhanë (2013)* etj.

GRATË E POETËVE

Sytë e bukur mbyllin. Po gjumi
nuk e di ku është mërguar, nuk e di.
Njëra përserit me vete një varg. Tjetra
një figurë sjell ndër mend... Si një lirikë dashurie
ledhaton pastaj jastëkun bosh në krahët e saj.

(...Vallë me kë u martuan burrat tanë,
me ne, apo me ty, poezi?...)

Një fjalë, një rimë,
një lumë dashurie dhe pak xhelozii,
Mesnata e krijimit çapitet si plak i ngadalshëm.

Vonë. Sytë e bukur mbyllin.

Dhe në endrra shohin vjershat e librave
të ardhshëm



Kalosh Çeliku, Dhimitër Pojanaku, Ramadan Sinani dhe Zyhdi Morava nën Rrap, në Shkup (1997).



Bardhyl Maliqi u lind më 19 korrik 1955.

PUNËSIMI:

Drejtues i Njesisë së Shërbimit Psikosocial, Zyra Arsimore Sarandë; pedagog - Filiali i Universitetit të Tiranës në Sarandë,

ARSIMI DHE KUALIFIKIMI:

Fakulteti gjuhë - letërsi, studime të thelluara në psikologji - pedagogji, Master në mësimdhënie, Doktor në shkencat e edukimit.

Ka shkruar 15 libra, prej të cilave janë botuar: “*Shije të rrezikuara*”(ese), “*Qortimi i hartimeve* (studim), “*Etika rrjedhave të komunikimit*” (studim), “*Pasqyrat*” (poezi), “*Morfologjia*” (tekst për studentët), “*Ankthi i statujave*” (libër me poema shqip - anglisht) etj. “*Detyrat e shtëpisë*” (ese), “*Mësimdhënia dhe vlerësimi etik*”, (studim), “*Tej portave të jetës*” (novelë), “*Perandoria e zogjve*“(poema) në shqip, anglisht & kroatisht, rumanisht etj.

DREDHËZA E ERËS

poemë për Bilal Xhaferrin
(Fragment)

Dredhëz e erës ja ndryshoi
drejtimin ajrit dhe u mbak
drita e diellit prej kuturbimit
dhe pluhurit dështak.
Pse duhej te perplaseshin dy uraganë,
dy meteoritë perse?
Dhe mllëfi rrugën zgjat e zgjat

nga toka gjer ne re!

Ditë të përgjakura enden në hapsirat e hirnosura
të viteve të trishta, të qiejve gri,
vaj për ty, biri ynë Bilal,
vaj për ty,
nëna jonë, Çamëri!

Bilal, ti më thoshe gjithmonë
të përkujdesem për dhimbjet e mia,
për dëshirat e atyre që më rrinë pranë!
Ti më këshilloje t'ua dhuroj të tjerëve dritën e
munguar,
forcën që ende nuk zotëroj,
shpresën, që ndjej të luhartet brenda meje,
besimin që shpesh më mungon.
Ti shpesh me thoshe:
ndriçoi nga errësira jote,
pasuroji me varfërinë tënde,
dhuroju një buzëqeshje
kur ke dëshirë të qash;
prodho hare
me stuhinë që ke brenda vetes.
“ Ta fal atë që s’kam, me gjithë zemër ta dhuroj!”.
kjo është parajsa jote,
do të vësh re që gëzimi,
pak nga pak do të depërtojë brenda teje
do të pushtojë qenien tënde,
do të bëhet vërtet i yti
po aq sa ti do t’ua kesh dhuruar të tjerëve.

Miku im,

pluhuri, gjaku e djersa bëjnë një aliazh të çuditshëm,
kur të mbjellat ulërijnë përgjatë rrugëve të varfërisë,
ku lëngatat e djersës njerëzore shtypen me këmbë,
ku pluhuri qep këmisha të vdekurish,
në trupa të shpërndarë,
si lulëkuqe të gjalla grunajave
dhe dielli fluturak thith ujin e fundit të puseve tanë,
ndërsa rrëketë heshtin në kallamat magjepsës ndanë
rrugëve,
e dëshira e fashitur është tek gjahu i lakmuar,
që djersa e vesh me sumbulla drite.
Gjaku ynë i mpiksur
fryn në zemrat e zeza shpresën e ndriçimit,
që vjen prej vargjeve të tua,
te “Balada çame”, te “Eja trishtim”,
te gjithë “Lirishta e kuqe”, që endet e përçartur si
mallkim
dhe pikëzohet te “Motrës sime Antikes”.
Bilal, bard i Çamërisë,
Bilal, bilbil i çamërishtes,
bir i përvëlur
i të zhuriturit, mallit tim!



Çezar Rica lindi dhe banon në Laç, Kurbin. Ka kryer studimet në Universitetin e Tiranës, në fakultetin e Historisë dhe Filologjisë dhe është diplomuar për Gjuhë-Letërsi. Nga viti 1995 deri në vitin 1997 ka drejtuar gazetën lokale “KURBINI“. Që nga viti 2001 e në vazhdim organizon çmimin letrar “Serembe“. Ka marrë pjesë në disa aktivitete ndërkombëtare të letërsisë. Klubi i Shkrimtarëve “Bota e re“ në Korçë e ka nderuar me çmimin letrar “Genc Leka“ në vitin 2005.

Ka botuar:

Ju nuk më njihni (poezi) Eurorilindja, 1996, *Po kthehet Atila* (poezi) Toena, 2001, *Kopshti i trëndafilave të Shirazit* (poezi) Toena, 2008 etj.

PORTRETI IM

Puthjet e tua, janë portreti im mbi një rrasë mermeri.

GRUAS

Larg teje,

Shpirti im

Është varkë e mbytur,
Në një det të verbër malli.



De Mersman Patricia lindi më 28 shtator të vitit 1959 në qytetin Malines. Momentalisht jeton dhe punon në Jette, komunë e Brukselit, në Belgjikë.

Duke shprehur gëzimin për jetë, një vogëlushe bjondinë e ka kaluar fëmijërinë e vet në qendër të një fshati të mrekullueshëm. Ishte duke shijuar erë të këndëshme gjatë shëtitjeve të gjata në shkurret e shqipeve dhe në pyjet e bredhave, kur çdo send u përmbys... Jeta sikur të ishte ndalur, dhe dëshira e flaktë për të jetuar plotësisht është shtyrë për shumë vite. Gëzimi i saj u ndërpre, për një kohë...

Përsëri duke u zgjuar ngadalë në gëzimin e jetës, rastësia bëri që të takonte me datën 20 janar të vitit 1980 Selajdin Sinanin, me origjinë shqiptar, i lindur në Shkup më 20 janar 1957. Ky ishte fillimi i një tregimi të gjatë, ishte simfoni e një jete të përbashkët, por sidomos zbulim, zbulim i dallimeve si: identiteti, kultura, gjuha, rrënjët. Të kuptosh, të dëgjosh, të shkëmbesh, tri fjali të thjeshta, por në veprim, megjithatë është shumë e vështirë. Gjithashtu nuk ka qenë punë e lehtë të hysh në rrethin, thuaja gati hermetikisht i mbyllur, të cilin e formojnë shumica e shqiptarëve në Belgjikë. Megjithatë, me gadishmëri për të dëgjuar, me diplomaci dhe me durim të madh, ishte punë e kryer kjo, sidomos duke bashkëpunuar me një gazetar i cili në atë kohë punonte në radion shqiptare ku ajo kishte recituar disa nga poezitë e saj. Dhe, sot e kësaj dite, ende i falënderohet atij, i cili më në fund e pati pranuar shkëmbimin aq të dëshiruar... dhe, gjithashtu, pa paramenduar asgjë, e inkurajoi atë në mënyrë indirekte që të vazhdojë të shkruajë.

Sot, vullneti i saj për të zbuluar dhe për të njohur popullin shqiptar në esencën e tij është ende shumë i ngulmët.

Më në fund, qëllimi i saj është që, përmes dashurisë që mban për popullin tuaj, të vërtetojë se kultura, historia dhe sidomos

ekzistenca e tij meriton të jetë e njohur. Si një kasnece “e jashtëligjshme“ e Ilirisë, ajo dëshiron të luftojë në anën tuaj, duke goditur me penë, për ta kërkuar të vërtetën dhe drejtësinë, por gjithashtu për të ndaluar mendimet negative të cilat janë ndërtuar tinëzisht rreth jush për t’ju shkatërruar, si popull me rrënjë të lashta.

Sot, dhurata juaj më e bukur është të pranoni shkëmbimin... Librin e saj me poezi në dy gjuhë: *Nostalgie pour un peuple - Malli për një popull*, të cilin e botoi SHGB “ASDRENI“, në Shkup (1998). Ajo e falënderon posaqërisht bashkëshortin e saj, i cili, i ngashëryer me poezitë e saj, e inkurajon për të vazhduar dhe për të publikuar...

DASHURI

Vullnet aq shpesh i zhgënjyer,
Ekulibër dhe dhembshuri
Aq shpesh i turbulluar,
Thesar i lakmuar,
Lufta e njeriut,
Tregim i jetës
Esencë e rrallë,
Substancë e paprekshme,
Që ka rëndësi thelbësore,
Paletë e artistëve,
Ngjyrë e jetës,
Në çdo kohë,
Ne kemi luftuar për ta ruajtur.

Rikëndoi: Fahri Ahmetaj



Demir Gjergji poezinë e parë e boton në vitin 1970.

Libri i parë “*Ngjyrat e tokës*”, sheh dritën e botimit në vitin 1974. “*Në sytë e mi*” është përmbledhja e dytë poetike e botuar fill pasi përfundon studimet në Ut Tiranë, për gjuhë letërsi.

Më 1997, pas kthimit nga Italia, ku qëndron 2 vjet si emigrant, boton librin me poezi “*Mërgimi i bukurisë*“. Në vitin 2000 nxjerr në qarkullim librin tjetër me poezi “*Vera në ikonë*“. 2001, nxjerr në qarkullim libri me profile shkrimtarësh “*Shtëpia e shkrimtarit*“. Një vit më pas boton përmbledhjen me poezi “*Digjet ylli i ikur*“. Në vitin 204 shkruan dhe boton monografinë “*Haxhi Gjyli, një jetë për shkollën*“. 2005- Boton përmbledhjen poetike “*Ishujt e mbrëmjes*“. Në vitin 2008 shtëpia botuese “Toena” i boton në serinë e poezisë shqipe, cikli “*Kambana*”, përmbledhjen poetike “*Vetëm (V)era vjen*“. Po në këtë vit i jep lexuesit adoleshentët një libër me përralla “*Pse nuk qeshte bija e mbretit*“. Para pesë vjetësh, pikërisht në ditën e Shën Valentinit të atij viti, ky autor u dhuron lexuesve të dashuruar përmbledhjen me poezi dashurie “*Bibla e buzëve*”, që është libri i parë i një triptiku botimesh me poezi dashurie. Botim tjetër është libri poetik: “*Orë akulli*”, si pjesë e dytë e triptikut. Botimi i fundit është romani “*Biri i Botës*“. Ndërkohë përmbledhja e tretë me poezi, që po përgatit për botim, me titull, “*Alfabeti i algave*”, është libri i fundit i triptikut.

Ndërkohë Demir Gjergji ka qenë dhe vazhdon të jetë mjaft aktiv në faqet e shtypit të shkruar dhe në median e folur. Ka 12 vjet që punon si gazetar në “Radio Tirana”, duke realizuar një nga emisionet më jetëgjata dhe më interesante “Fjala si Fillim,

Fjala si Flijim", i cili i kushtohet tërësisht letërsisë dhe autorëve të saj.

Krijimtaria e këtij autori është vlerësuar me çmime të ndryshme si Çmimi i dytë kombëtar për poemë në vitin 1986, Çmimet “Ditët e poezisë Shqipe” në vitin 2001, “Skampini” etj.

ERËMIM I ERRËT

ODE PËR DASHURINË

Luleshqerrë mbirë në erë,
Endesh udhëve të mia...
Shprishur shpirti ndajnatëherë,
Hirehumbur Gjithësia!
Luleshqerrë, erëmim i errët,
Rrënon eshtra, ngre kështjella,
Shfaqesh, tretesh përmbi jetët,
Vetmon plagëve të thella!
Luleshqerrë, dëborë e diell,
Mbromë nga ëndrrat, nga vetvetja,
Hapmë qiell, thellomë shpellë,
Ta marr vesh se ç'është vdekja!



Delvina Kërluku lindi në Dibër më 1988, ku kreu shkollën fillore dhe të mesmen (gjimnazin). Diplomoi në Universitetin e Evropës Juglindore dhe ndoqi studimet në Fakultetin e Administratës të Biznesit. Delvina Kërluku deri më tani botoi këto libra: *Muza*, poezi (2004), *Altar* (poezi,), *Gjurmë*, (poezi,) *Varg vese* (poezi) *Fjordet e vetmisë* (poezi), *Pasthënie e ditëve tona* (tregime,

2016) etj.

VERIM NË ËNDËRR

Pranë bregut
 të Durrësit rri
 mu atje pranë
 rërës së lagur
 këmbëzbathur
 të lagur nga lumi i njelmët
 rrezitje nga dielli
 zhurma turistësh
 unë rri
 në pushim atje
 pranë detit të qetë
 dikush thërret
 hapa sytë, ëndrra ik...



Dashnor Selimi u lind në gusht të vitit 1966 në Goricë të Dëshnicës së Përmetit. Është marrë me letërsi që në moshë të re, duke botuar poezi, tregime, dhe publicistikë në organe të ndryshme të shtypit lokal e qendror. Ka botuar këto libra: "*Jetë në dallgë*" 2000, "*Dritëhijet*" 2002, "*Lulet e vrara*" 2004, "*Engjëjt e heshtur*" 2006, "*Lirikat e anëvjoses*" 2009, "*Mesha e mbrëmjes*" 2014, poezi. Është fitues i disa çmimeve letrare si në vendlindje ashtu dhe në emigracion. Është gjithashtu korrespondent i Gazetës së Athinës për Selanikun dhe reporter i Radio Sarandës në Greqi.

Në vitin 2005, libri "*Engjëjt e heshtur*" vlerësohet me çmimin e parë nga Lidhja e Krijuesve "Pegasi Albania"; në vitin 2003 Shoqata "Nënë Tereza", në konkursin vjetor, e vlerëson me çmim të parë në publicistikë; në 15 nëntor 2015 Lidhja e Shkrimtarëve Shqiptar të Maqedonisë i jep çmimin vjetor të poezisë në takimet e vjeshtës të organizuar në Kërçovë.

Për krijimtarinë e tij letrare janë realizuar disa emisione televizive dhe radiofonike në Shqipëri dhe në Diasporë...

QAN NJË VAJZË NËPËR SHKËMBINJ

Bie shi.

Pulëbardhat i mungojnë detit.

Shpirti im fillon e loton.

Befas gjëmon deti,

vrullon era,

thellë mes leshterikëve,

përkundej një kostum dhëndërie.

Në breg, nëpër shkëmbinj,
qante një vajzë.

Me fustanin e nusërisë në duar.



**Rexhep Bajrami, Kalosh Çeliku dhe Fadil Curri
para këmbëve të Olimbisë, në Shkup...**



Dashamir MALO

Dashamir Malo lindi në Përmet. Pas mbarimit të Shkollës së Mesme në Përmet (sot Gjimnazi "Sejfulla Maleshova"), mbaroi Akademinë Ushtarake dhe më vonë Akademinë e Policisë. Prej vitit 1990 -1997 punoi në profesionin e tij në qytetin e Sarandës. Në vitin 1997 emigron në Athinë - Greqi ku vitin 2002. Në Greqi përfundoi shkollën dy vjeçare për pikturë. Në vitin 2003 rifillon përsëri punë në profesionin e tij si Oficer Policie dhe aktualisht është Shef Administrate në Komisariatit e Policisë Kufitare Sarandë.

KaAutori deri tani ka botuar këto libra me poezi: "*Midis vetmisë dhe heshtjes*", "*Precedent*" dhe "*Fshehja e Lotit*". Ka perkthyer nga greqishtja vëllimin poetik "*Poezi te zgjedhura*" te poetit publicistit dhe gazetarit grek Jorgos Hronas si dhe librin me esse "*Vallja e cmendur e Merylin Monroe*".

SARANDA

Lart pafundësi e kaltër,
poshtë kaltërsi Joni,
në mes një shall reje i bardhë,
gri dhe ngrehina prej betoni!

Lakmi ta kam GRUA!
Nënë, Lindja ime...
Të dua GRUA!
Motra ime...



Dhimitër Pojanaku lindi në gusht 1956 në Pogradec. Është diplomuar për drejtësi në Universitetin e Tiranës, aktualisht punon gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Ka botuar vëllimet poetike: "*Shiu lexon trishtimin tim*", "*Mëngjes dhe pak natë*", "*Xhindet kërcëjnë polka*". Vëllimit poetik "*Gurët zbardhin natën*", botuar në vitin 2002, i është akorduar çmimi "Penda e argjendtë", si libri më i mirë i vitit. Pojanaku është laureat i shumë çmimeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Poezitë e tij janë përkthyer në disa gjuhë të huaja. Në vitin 2005, për poezinë e veçantë i akordohet titulli "Qytetar nderi i Pogradecit". Tani ka në proces krijimi vëllimin poetik "*Qielli vdes në hon*".

XHELOZI

Tek fshije oborret,
T'u zbulua gjiri,
Gurët e sokakut,
Zunë të lëvizin.

Gurët e sokakut,
Trembur bukurie!
Fshesa prej inatit,
U bë fije-fije!



Etleva Tafa (1975) Lindi në Tiranë. Shkollën fillore, atë të mesme dhe studimet e larta I mori në vendlindje. Shkruan poezi e prozë për të rritur. Etleva Tafa punon dhe jeton në Tiranë. Autorja deri më tani botoi këta libra: *Gjithësesi e buluar në lot*, poezi (1996), *Parfumi ndërrohet*, tregime (1997), *Simfonitë e leopardit*, poezi (1998), *Hija e flokëve të tua*, tregime & poezi (1999), *Tersun*, tregime & poezi, *A thua mendon për hënën time*, poezi (2003), *Një E-mail për Olimp*, poezi (2006) etj.

Itaka!

Në djall vaftë!
Përderisa ti nuk kthehesh kurrë
Në të njëjtin vend
Në të njëjtën orë.

Në dyqanin e mishit
Kasapi më bëri kompliment
Më tha se i ngjaja shelegut të pranverës
Jam vegjetariane i thashë
Dhe nuk më pëlqejnë deshtë e flijuar.

Pse më kafshon
Kur unë të puth?
Nata më mbështjell
Me lëkurën e çudisë
Se ti je një tjetër!



Entela Safeti Kasi poete, romanciere, përkëthuese dhe eseiste. Është diplomuar për gjuhë angleze, më 1998. Është çertifikuar në United Kingdom, për Integrimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, më, 2004 Është çertifikuar në Finlandë nga Federata Ndërkombëtare e Përkthyesve të Letërsisë, për “Përkthim letrar dhe të drejtat e autorit” më, 2005, nga Këshilli i Europës, për dialog në ndërkultura, më 2008.

Është ftuar nga FIT-Federata Ndërkombëtare e Përkthyesve dhe International PEN, Organizatë Botërore për Shkrimtarë, si shkrimtare dhe poete e gjuhës Shqipe në aktivitete të ndryshme të Interanational PEN, në Ballkan, Europe, dhe Azi (Maqedoni, Turqi, Greqi, Angli, Finlande, Paris, Berlin, Londer, Slloveni, Norvegji, Shangai, etj. Është përkthyer dhe botuar në revista letrare dhe antologji poetike në, maqedonisht, turqisht, spanjisht, anglisht, frengjisht, si edhe në gjuhën arabe dhe gjuhën portugeze. Ka marrë pjesë në festivale ndërkombatare të poezisë si “Struga Poetry Evenings” në vitet 2001 dhe 2002, Izmir 2007, etj. Poezia e saj është vlerësuar në Festivalin Nderkombetar te Poezisë në Izmir, 2007 dhe në Manifestimin Tradicional Ndërkombëtar: TAKIME NËN RRAP, në Shkup, 2007.

VEPRAT: Poezi: ËNDËRR E PAEMËR (1993), KOHA E KALIT (2000), NË KËTË MUZG PIKËLLIMI (2005), botuar në dy gjuhë, anglisht – shqip. **Prozë:** PASION DHE KRIM – roman (2003). **Përkthime:** Ka sjellë ekskluzivisht për gjuhën shqipe poezi nga poetë të International Pen përmes Antologjisë poetike Metafora që (s)’falen, 2007.(22 poetë bashkohorë nga 17 vende të botës).

TRËNDAFILI I TETORIT

(*cikël*)

...Dritë, shtangur në pikëllim
bëhu e qartë, bukur!

Si dashuria që mban,
si motivi që këndon me gaz shpresën
që mbërrin tek ti
prej dritaresh të trishta
Loti nuk mjafton për të puthur
buzën e dridhur
Lutja po! Buzën që lut pëshpërima
të jetosh, i bukur i qartë
i fuqishëm të ngrihesh të sfidosh
si ti di...
Njeri i botës që kapërthehesh
limiteve
kufijve të saj.
E ti ngrihu!
Pi një pikë uji jetik me mua
në globin që rrotullohet
ditë netëve
ankthit,
jeta ka vetëm fillim
si dita që e nisëm bashkë
si rruga që e patëm nisur
si shtëpia që po ndërtohet
si dashuria
si fëmija që lindet...
Dritë, bëhu e qartë!!!
E pi një pikë uji
lëngun e buzëve
dehës në marramendje
në dashuri pa frikë....

...Nën këtë qiell të trishtë endem
si ëndrrat në perëndim të kuq
me natën që mbërrin vetmuar
në liman të dashurisë që pret
në një anije të vjetër...



Emin Mamudoski lindi në Kërçovë (1956) në një familje punëtore me 13 fëmijë. Shkollën fillore dhe të mesmen e keru në vendlindje, Kërçovë. Gjatë një kohe ndoqi edhe shkollën politike 1982/83. Gjatë kohë punon si punëtor metalik. Është aktivist i disa shoqërive kulturore - artistike.

Autori deri më tani botoi këto libra: Fisi im i përvuajtur, poezi (1955), Egjiptët në Kërçovë dhe rrethinë, punim shkencor (1969), Zakone verore (2000), Rruga kah ndriçimi (2010) etj.

Fjala e fundit

Mbaroi loja e jetë
 Rregullat janë të huaj
 Tjetër i caktoi
 Fjala e fundit
 Në pamundësi i tregova
 Për mbrojtje ndërtova pendë
 “Jeta ime”
 E luajta rolin e findit
 Ajo që ishte caktuar
 Tash trup i shprazët
 Shpirtin më se ka 21 weds
 “Zotëri”
 Vallë tash fillon
 Fillimi I ri në nbarim
 Lëshomëni nga prangat
 Të shikoj fatbardhësi
 Ta shijoj parajsën...!

(Rikëndoi nga maqedonishtja: K. Çeliku)



Fatime Kulli lindi në Durrës më 22 korrik 1957. Banore e qytetit të Shkodrës. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në vendlindje. Studimet në Tiranë. Autorja deri më tani botoi këta libra: *Ma leni portën çelë* (poezi), *Lakuriq mbi tastierë* (poezi), *Mastruboj me diellin* (poezi), *Parlament në pyll* (fabula), *Zemrën e dua pasqyrë* (poezi), *Tensione emocionesh* (tregime),

Ethet e çveshura (poezi shqip-italish), *Deti mbytet në guacë* (poezi), *Shkëndia e eshkës* (poezi), *Trëndafili i djersitur* (poezi), *111 fjalë të ndyra* (prozë & poezi), *Në gojë të diellit* (poezi për fëmijë), *Cila është më e bukur* (poemë për fëmijë), *Drithërimat e frikës* (roman), *Uragani i metorëve* (monografi), *Mitra e zjarrit*, poezi (2005) etj.

"Armik i poezisë"

Nëpër mure
të nevojtoreve publike
do ta zhgarravis emrin tënd.
Nëpër rreshta të poezive
do të pështyj
nëpër filtrin e cigares
do të të shtrydh!
Do të të flak
si leckë e vjetër
nga fletët e kalendarit tim
o shpirti im
"Armik" i poezisë!



Fadil Curri lindi në Dërmjak të Hanit të Elezit (Kosovë) në vitin 1959. Shkollimin fillor, gjimnazin “Zef Lush Marku” dhe Fakultetin Filologjik, dega Gjuhë Shqipe e Letërsi i kreu në Shkup. Me dekada punoi në gazetari, pastaj në arsim, ishte edhe drejtor për kulturë, rini e

sport në komunën e Kaçanikut në mandatin e parë të pasluftës. Në vitin 1998 i ndalua të hyjë në Maqedoni dhe sot e kësaj dite i mohohet marrja e shtetësisë së këtushme, të cilën e kishte në rini. Merret me krijimtari letrare, disa krijime edhe iu shpërblyen nëpër konkurset letrare në Kosovë e Maqedoni. Tekstet letrare e gazetare iu përkthyen në disa gjuhë të botës.

Është autor i këtyre librave:

“*A(h) fati(h) ynë në peshojë*”, me tekste publiciste e dokumentare për krimin e brigadave komuniste e çetnike ndaj fshatarëve të pafajshëm të Bllacës së Shkupit, shënime nga Belgjika e Gjermania, shkelja e të drejtave të shqiptarëve në ish - Jugosllavi.

“*Kohë qorre - a blind time*”, përmbledhje poezish në shqip e anglisht.

“*Kronikë për një dashuri*”, roman që shtjellon temë të marrëdhënieve shqiptare-ballkanike nga vëzhgimet e ndërkomëbetrëve, simptomat e paraluftërave në Ballkan.

“*Rinjohja pas vdekjes në Kosovë*”, vazhdim tematik i romanit të mëparshëm, në të cilin jepet skena nga lufta e Kosovës i një gazetari botëror.

“*Muzat e Hanpencit*” qasje e panoramë kulturore-letrare të rrethanave në Han të Elezit.

“*Tregime për fëmijë*”, proza letrare për fëmijë, *Kështu mendonte, fliste e shkruante Adem Kastrati*, publicistikë (2009) etj.

Fadil Curri jeton në Han të Elezit dhe punon në sferën e arsimit..

MOSNI

Ju po më verboni përgjumshëm në mesditën me diell
Po më bëni syhapur si shtërg natën e bekuar për gjumë

Vërtet po kam neveri nga ushqimet që po na i bëni
Nuk di pse po u vie duhmë peshku baltik
Mos po e lagni miellin me ujë të njelmtë Egjeu
Ju e hëngrët poçen me m... të mjaltosur
Të këtillë doni të na qerasni edhe ne

Natën e Madhe të Ripagëzimit me formulë tjetërfare
Besoni, ky bios nuk i shkon për shtati jetës time

A e dini se në Puset e Nikës zotërinjtë përgjigjen para
zotërave,
zotërat para Zotit
se kush e vrau Vdekjen gjatë varrimit pa Gjurmë.

Ju njoh që gëzofët ideologjikë i ndërroni edhe verës
E në dimër nuk ngopeni me borën e kuqe

Nuk jam fëmijë të më levërdisni me akullore
Ajo është e kremosur me shurrën e Lenës.

Mosni, ajo i bën intelektualët të bëhen vrastarë,
të vrasin vetëvrasjen e narkotizuar.



Flora Brovina lindi më 30 shtator 1949 në Skenderaj.

Studimet në Fakultetin e Mjekësisë i mbaroi po në Prishtinë.

Ka botuar disa vëllime me poezi:

- "*Vërma emrin tim*" (1973)

- "*Bimë e zë*" (1979),

- "*Luleborë*" (1988)

- "*Mat e çmat*" (1995)

- "*Thirrje e Kosovë*" (1999, në

kohën kur ajo ishte në burgun e Pozharevacit në Serbi).

Në vitin 1999, në një kohë kur fati i Flora Brovinës pas arrestimit ishte i panjohur, ajo mori Çmimin Tucholsky për vitin 1999 "in absentia" nga PEN Klubi Suedez.

VERMA EMRIN TIM

Nëse më njeh – e di emrin tim

ka emrin e fluturimit

nëse e di emrin tim mos më thirr fluturim

Nëse më ke parë – e di kush jam

i kam krihet e thëllëzës

nëse e di kush jam mos më thërrit thëllëzë

Nëse ke dëgjuar këngën time – e di si këndoj

vëlla e kam bilbilin

nëse e di si këndoj këngën mos ma ndal

Nëse lotët i urren – e di se unë nuk qaj

qyqen nuk e kam fis

nëse e di se nuk qaj mos më thuaj se nuk ndjej



Reshat Sahitaj duke ia dorëzuar Çmimin letrar: “E percolla Natën” për vepër letrare Radije Hoxhës, Rami Kamberi dhe Kalosh Çeliku, në Shkup (2015).



Fatmir Minguli, një njeri me kulturë të gjërë, një njeri me vizion e shpirt të madh siç është Fatmir Minguli mund të shkruaj një libër studimor ashtu si është libri “Triptik historik”, botim i shtëpisë botuese “2mprinting” në Durrës. Në Durrës kush nuk e njeh Fatmir Mingulin, Fatmirin njerëzor, studjues e eseist, inxhiner duarartë dhe qytetarin e kulturuar! Si është e mundur që të bëhen të gjithë këto gjëra bashkë, këto vlera që ka ky njeri me vizion dhe me vlera të veçanta?! Fatmir Nivica (Minguli), kështu kam qejf t’a quaj që kur u takova për herë të parë me të. Ai prezantohet në bisedë si një njeri me formim të gjithanshëm shkencor, letrar e shumë dimensional.

Macet

Eshtë një natë shkurti dhe ora po shkon rreth 2.00 e natës . Bari ynë është në bulevardin kryesor të qytetit bregdetar. Unë sapa e hapa barin, sepse ishte si të thuash gjysmë “non stop”.

Përveç dy muzikantëve të përnatshëm dhe një çifti që priste autobuzin e linjës Durrës- Athinë, në bar s’kishte klientë të tjerë. Unë po rrija jashtë në një nga tavolinat që nxirrim zakonisht edhe në dimër, aty në trotuar, afër murit. Muzikantët kishin tavolinën plot me uiski dhe Red Bull, ndërsa çifti po pinte ngadalë nga një kafe frappe.

Kështu që isha i qetë tek sodisja një mace që po i vinte reth e rotull një qeseje me mbeturina peshku, hedhur nga restoranti aty ngjitur me ne. Macja qe e bukur, e bardhë dhe

nuk të jepte përshtypjen për mace rrugësh, por ndoshta një mace që kishte ikur nga një ato shtëpitë njëkatëshe e me avlli që ishin mbrapa pallatit tonë.

Ishte një mace që i druhej asaj qeses sepse e shikonte dhe nuk guxonte t'a hapte. Era e mbeturinave të peshkut ishte akoma e fortë, sepse ndihej deri në anën tonë të trotuarit. Tek mundohej t'a hapte, papritmas mbrapa kazanit të plehrave u duk një dac i cili po i afrohej krejt tinëzisht maces. Unë nuk po e kuptoja qëllimin e dacit bojë gri. Donte të merrte pjesë në hapjen e qeses, natyrisht për t'u treguar xhentil, me macen e bardhë, apo thjeshtë donte të merrej me vetë macen.

Ishte muaji shkurt dhe ishte koha e maceve nocturne. Ndoshta mund të ishte thjeshtë një dac i rëndomtë që rrëmonte kazanet e plehrave. Ndërkohë erdhën klientë të tjerë, e pasi mbarova punë brenda barit, dola me nxitim për të ndjekur skenën me macen e bardhë dhe dacin gri. Nuk ishte dac i zakonshëm, ai po i rrotullohej maces nazike dhe me siguri i kërkonte atë që daci kërkon në një natë shkurti, ku bënte shumë pak ftohtë. Pas pak kohe daci po e arrinte qëllimin. Macja e bardhë po i bindej dhe i tundte kokën, mbase ishte shenja e mirkuptimit. Unë isha përqëndruar I tëri pas kësaj skene që ndodhte në trotuarin përballë.

Prisja që të zhvillohej skena finale, kur papritmas nga fundi i trotuarit erdhi me vrap një dac tjetër, krejt i zi. Iu turr dacit gri, e shtyu dhe i gjuajti me kokë deri sa e plandosi për dhe. I kërcëu maces së bardhë përsipër dhe...

Në atë kohë më erdhën klientë të tjerë dhe kur unë dola gati mbas gjysmë ore, daci i zi dhe macja e bardhë përkëledheshin ndërsa daci gri ishte zhdukur.



Gjon Gjergjaj lindi më 15.02.1951 në fshatin Krushevë e vogël të Klinës. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Klinë. Autori deri më tani ka botuar disa libra me poezi për fëmijë e të rritur dhe drama: *Lisat e Nakalit* (poezi),

1989, *Bukuroshja e detit* (poezi), 1992, *Kroje ëndrrash trëndafili*, poema për fëmijë (1992), *Lulja që i priu detit*, poezi (1994), *Shembje sfinksash*, dramë (1997), *Përralla ka atdhe*, poemë (1997), *Kali i Shtrigës*, dramë (1998), *Përralla ka grevë urie*, poezi (2000), *Karazuzari*, burleskë dramatike (2002), *Edhe dhia do taxhi*, poemë satirike (2002), *Rrugën e diellit, dallëndyshe e more*, drama dhe pjesë teatrore (2002), *Kamelonët zbresin shkallëve të Parajsës*, komedi (2004) etj.

BUKUROSHJA E DETIT

Zhytemi mbytemi
deri në fund të detit,
ecim pas frymëzimit
të një poeti.

Zemrat stolisin malin,
ujëvareve të Mirushës
ç'gjurmojnë ata çuna
trëndafila të fushës?

Bukuroshja e detit
solli në Miradi
valët e argjendta
për mua e për ty.



Irena Gjoni ka lindur në Sarandë. Doktore e shkencave në letërsi (në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tiranës). Master Shkencor për letërsi. E diplomuar për gjuhë letërsi. Ka punuar si gazetare në median e shkruar dhe audiovizive. Aktualisht është pedagoge e jashtme në Universitet dhe mësuese letërsie në gjimnaz.

Autorja deri më tani ka botuar këto libra: “*Tatuazh në shpirt të detit*” poezi (2003), “*Marrëdhënie të miteve dhe kulteve të Bregdetit Jonian me ato ndërkuftare*” studimor (2008), “*Gjysma dashurish*” vëllim me fikcione (2010), “*Maja malesh e magmë jonike*” poezi (2011), “*Poetry*” poezi (2013) etj.

DASHURI BUZË GREMINE

Bëmë dashuri buzë një gremine
Në mollëzat e gishtave të tu,
një cermë hëne të prek

Me ty ëngjëll jam dashuruar unë,
Me ty nata e greminës,
Me ty hëna e njohur si hajdute zemrash

S’di kujt t’ia prishësh

Gremina të josh me fundin e mistershëm
Gëlltit një copë gremine
Hëna të josh me cermën e saj
Gëlltit një copë hënë

Thua se unë të josh me sekretet e pathëna
Gëlltit një sekret timin

Mua më duhet të të shpëtoj
prej vetes sime, greminës dhe hënës
Duke të futur në një akvarium shpirti
të padepërtueshëm prej shumë palë sysh njëherësh

se dashuria ha koka...



**Pano Taçi nën Rrap me një poezi të egër dhe
Valbona Zunçe, udhëheqse e programit...**



Iliaz Bobaj u lind në fshatin Lazarat të Rrethit të Gjirokastrës, në një familje me tradita atdhetare dhe kulturore.

Shkollën fillore e filloi në vendlindje, por e vijoi dhe e përfundoi në qytetin e Delvinës, ku u shpërngulën familjarisht. Në qytetin e Delvinës përfundoi edhe shkollën e mesme.

Ka kryer studimet e larta për matematikë dhe fizikë në Institutin e Lartë Pedagogjik të Shkodrës dhe në Universitetin "Eqerem Çabej", në Gjirokastrë, po në këtë degë.

Ka punuar mësues në rrethet e Sarandës, Delvinës, drejtues shkolle në qytetin e Delvinës, drejtues i Shtëpisë së Pionierit Delvinë dhe gjatë viteve 1992-1997 ka kryer detyrën e Sekretarit të Këshillit të Rrethit të Delvinës. Prej vitit 1997 ka emigruar së bashku me familjen e tij në qytetin e Patrës, (Greqi), ku jeton edhe sot.

Është autor i librave: *Dora dhe faqja* (fabula), *Dhelpra dhe gjyqtari* (fabula), *501 fjalë të urta* (fjalë të urta).

Molla e sherrit (fabula), *Tregu i fjalës* (epigrame), *Dino Buzzati ndalohet në doganë* (tregime satirike), *777 fjalë të urta* (fjalë të urta), *Kali i pushtetit* (fabula, poezi satirike, epigrame), *Zogjtë e ballkonit tim* (poezi për fëmijë) etj.

Është autor i disa përkthimeve: *Ezopi* (vepra e plotë, fabula), *Harta e grisur* (Ali Podrimja, poezi, greqisht), *Plaga e dhjetë me hënën* (Kalosh Çeliku, poezi, greqisht). *Në detin e bukurisë* (Panajota Zalloni, poezi, shqip), *Etje për qiell*, (Panajota Zalloni, poezi shqip- greqisht), *Dashuri në Butrint* (dramë, Dino Kubatis, shqip), *Këpucët e Van Gogut*, (tregime,

Kostas Valetas, shqip, libër fitues i Çmimit Letrar Ndërkombëtar: "Kepi i Shpresës së Mirë- Fahredin Gunga", për vitin 2011, Prishtinë), *Drita e Lesbos* (tregime, Kostas Valetas, shqip), *Nëna Shqipëri* (dramë, Dino Kubati, shqip), Agim Gjakova (poezi, greqisht), Agim Vinca (poezi, greqisht), Mujo Buçpapaj, (poezi, greqisht), *Gjërat e harruara*, Jeton Kelmendi, (poezi, greqisht), Kavafis- Seferis- Elitis (antologji poetike, shqip) etj.

TROJA

E patundur qëndron në histori.

Bie atëherë kur duhet të ringrihet.

Ngrihet atëherë kur duhet të bjerë përsëri.



Kalosh Çeliku lindi më 13 shkurt

1951 në fshatin Cërivicë të Kërçovës (IRJ e Maqedonisë). Shkollën fillore e kreu në vendlindje. Shkollën e mesme normale në Shkup, ndërsa studimet e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin e Prishtinës (Kosovë). Çeliku shkruan poezi e prozë për fëmijë e të rritur dhe gjer më sot ka botuar rreth dyzetë libra: *Zogu erdhi me një këngë* - vjersha (1982), *Lepuri me pushkë* - tregime

(1983), *Shtëpiza e xixëllonjave* - tregime (1984), *Ferexhja e zezë* - dramë (1985), *Arusha pa bisht* - tregime (1986), *Dielli zbret maleve* - novelë (1986), *Varrimi i sorrave* - roman (1988), *Vite me borë* - roman (1990), *Trumbetat e Tellallit* - satira (1992), *Imzot, lehin qentë* - drama (1993), *Trimi shihet në vepër* - poemë (1994), *Çohuni trima shaloni lapsin* - rrëfenja (1994), *Sorraku i Qytetit* - pjesë teatrore (1994), *Kali i Trojës nëpër Bit - Pazar* - satira (1994), *Loja e syve* - poezi (1995), *Babi ka dy nuse* - roman, (1995), *Vjellja e zorrëve* - poezi (1996), *Qyteti i qyqeve* - roman (1997), *E përcolla Natën* - poezi (1998), *Mbrëmë fjeta me Vjesh tën* - poezi (1999), *Kopeja me zgjebe ndjek Autorin* - drama (2000), *Shtëpia publike* - roman (2000), *Si u ndava me Gruan time* - satira (2001), *Gratë e mia besnike* - roman (2001), *Lamtumirë bërlllok* - nëntë drama (2002, 2007), *Me tre varre* - roman (2002), *Vdekja më deshi më pak se Ti* - poezi (2003), *Edhe Ajo nuk ishte xheloze* - poezi (2004), *Repriza e Vëllazërim - bashkimit* - dramë (2005), *Atdheu ky burrë pa Grua* - poezi (2006), *Kulturofagu* - antiroman (2006), *Burrat i përzë me burra e Mua me gra* - poezi (2007), *Engjëlli im është Grua* - poezi (2007), *Dimri, s'vjen me lule* - 5 poema (2007), *Ujku e di një lojë* - poezi (2007), *Kur bërtet "vojvoda" e pjell Kurvë Partia* - satira (2008), *Dac Poeti i shkruan poezi Mamit* - poemë humoristike (2008), *Ehu* - poezi (2008), *Gruaja besnike* - roman, (2009),

Djemnusha, roman (210), *Xhadia*, publicistikë letrare (2011), *Cuca Boheme* u jep gji poezive të mia – poezi (përzgjedhje në gjuhën gjermane (2012), *Plaga e dhjetë e Babait* – roman (2012), *Rruffjani* – publicistikë letrare (2012) *Qengji më tha: ha bar* - roman (2013), *Plaga e dhjetë me Hënën* – poezi (përzgjedhje në gjuhën greke (2013), *Gruaverë* – poezi, përzgjedhje (2013), *Imzot, lehin qentë* – dhjetë drama (2013), *I fshehur pas Hënës* – poezi (përzgjedhje në gjuhëm rumune, 2014), *Lavdi heronjëve të Xhadisë* – publicistikë letrare (2014), *Zonjën Vdekje do ta marr për grua* – poezi (2015), *Dudumi gërhet për Liri* - dramë (2016, 2018), *PYKË Shelgu* - publicistikë letrare (2019), *“Kali Shemës” pas porte*, publicistikë letrare (2019), *Rrugacja* - lirika të cmendura letrere (2019), *Koronavirusi* (poezi, 2020) *Gratë e mia besnike* (Libër me tre romane, 2020). etj.

Që nga viti 1992 ai drejton Shtëpinë Gazetare - Botuese **ASDRENI**, në Shkup dhe është kryeredaktor i të vetmes revistë për humor dhe satirë **ZEKTHI**, që del kur t’i teket në IRJ të Maqedonisë. Dhe, që nga viti (2009) mbarëkombëtarë. Është fitues i disa çmimeve të konkurseve letrare në poezi, tregime dhe pjesë teatrore. Njëherit, edhe i çmimeve letrare: PERENDESHË E BUKURISË, Klubi i Shkrimtarëve “Bota e Re” - Korçë, në Netët e Poezisë Korçare (2003), në Korçë , Shqipëri, Çmimin AS për letërsi në Kërçovë, IRJ e Maqedonisë (2007), “SYRI I KALTËR“, në Sarandë, Shqipëri (2007), “FLAKADANI I KARADAKUT“, Kuvendi i Komunës Viti, Kosovë (2008) dhe “SEREMBE“, Klubi i Artistëve të Laçit, Shqipëri (2008), “JEHONA E KARADKUT” (2010), në Kumanovë, “SKAMPIN” në Festivalin Ballkanik të Poezisë, në Elbasan, Kurora e poezisë “KORÇA 2012), në Korçë, Çmimin e parë për poezi të vitit (2014) “PAVARËSIA” e Kosovës nga Unioni i Shkrimtarëve dhe Kritikëve Shqiptar, në Prishtinë, METAFORA II (2014) nga Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës, Medaljen e artë “Aleksandri i Madh” (2015) nga Shoqata Kulturore e Salaminës KAFENEJA E IDEVE, Çmimin UNESKO (Greqi) etj. etj.

Krijimtaria e tij letrare është përkthyer në disa gjuhë:

bullgare, gjermane, turke, rumune, etj. Që nga viti 1997 është kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptarë në IRJ të Maqedonisë. Dhe, themelues i disa manifestimeve kulturore tradicionale ndërkombëtarë: **Ditët e Naimit**, në Tetovë, **Takime nën Rrap**, në Shkup (poezi erotike) dhe i Ditëve të humorit dhe satirës: **XHA DERALLA**, në Kërçovë. Poashtu është edhe themelues dhe kryeredaktor i revistës letrare **STILI 97**, organ i Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptar në IRJ të Maqedonisë.

Çeliku gjer më vitin 1995 punoi si mësues i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Drenicë të Kosovës dhe Malësinë e Shkupit. Vitet e fundit punon dhe jeton në Shkup, tashmë në profesionin e lirë të shkrimtarit.

Unë jam Ujk. Dhe, dua plagë

Grua, natën e mirë! Ika.
Pasmesnate, më pret një Grua tjetër:
Poezia. Dhe, është xhelozë.
Nëntë burra nuk mund ta bëjnë zap
Natën. Vetëm Unë ia jap hakun.
Grua, natën e mirë! Ika
Falemnderit. Që, nuk je xhelozë.

Grua, mirëmëngjes. Erdha
Unë jam Ujk. Dhe, dua plagë!
Edhe, Ajo nuk ishte xhelozë.

I dëbova armiqtë rreth Meje. Edhe Miken
Vetëm Poezinë nuk mund ta përzë. Nuk ikë.
Është, Grua besnike. E do burrin...



Kostas Valetas u lind në ishullin e Lesbos dhe ka jetuar shtatë vjet në Francë dhe Zvicër, (1967 – 1973). Është drejtor i revistës “Eolika Grammata” dhe president I Kongresit ndërkombëtar, që organizohet çdo vjet në Lesbos.

Autori deri më tani botoi rreth 60 libra: (tregime, esse, romane, vepra teatrale, përkthime, kritikë letrare).

Është përkthyer në njëzet gjuhë të huaja (ndërmjet të tjerash: anglisht, çekisht, italisht, rusisht, frëngjisht, arabisht, japonisht, kinezçe, shqip, bullgarisht, rumunisht, turqisht). Është nderuar me Çmimin Kombëtar të prozës dhe në vitin 2003 me Çmimin Kombëtar Blezë Shandar.

DRITA E LESBOS

(Fragment)

*“Nëqoftëse do të arrinte t’i largohej
magjisë së saj, do të ndërmerre
vepra të mëdha...”*

Prifti filloi ceremoninë mortore në kishën e mbushur plot e përplot me njerëz. Asnjëri prej nesh nuk fliste. Veçse vija re se ata përreth meje, ngrisin kokën lart, pëshpëritnin midis tyre. Nga pjesa e kishës e rezervuar për gratë, dëgjohej një zhurmë e vazhdueshme si ngashërim. Si një ankesë e zgjatur, si një dënësë e mbytur. Një grua u mundua të shuante vajtimin e saj, I cili i doli nga kontrolli dhe arrinte deri tek veshët tanë.

Ishte ajo! Në hyrje të kishës kishte qëndruar në një cep, thua se përpiquej të kalonte pa u vënë re. Ishte e veshur me të zeza, ishte e palyer, e zbehtë, e zhytur në lotë. Por asaj i afroheshin artistët më të shumtë dhe njerëzit e letrave, asaj i shprehnin ngushëllime. Të shoqen dhe të birin e piktorit i kalonin duke mos u dhënë ndonjë rëndësi, sepse të gjithë ata që nuk i njihnin, i merrnin për të afërt të largët ose miq. Arriti deri aty sa të formohej një radhë e gjatë në drejtim të saj, ndërsa e veja mbeti e harruar në hyrje të kishës.

- Akoma nuk mund ta besoj, - i thashë skulptorit Lazara, se si një piktor si ai, binte në këmbët e saj, lypte dashurinë e saj, i përgjerohej dashurisë së saj.

- E vure re se askush nuk kthen kokën për të parë të venë e tij të vërtetë? Se gjithka u përqëndrua tek mikesha e tij?

- Ajo grua e shkatrroi!

- Je i sigurt për këtë? Krijimtaria artistike është e pazgjidhshme, një dukuri e pa shpjegueshme, e cila nuk pranon interpretime të lehtë.

- Që atëherë që e njohu, që u përshtat me të, realisht nuk dha asgjë. Ndaloi së pikturuari ullinj, u kufizua në portretet e saj. Vepra e tij, e cila lahej në dritë, u errësua. Filloi të përdorte ngjyra të errëta. Vetëm vishnjën dhe të verdhën e gjeje herë-herë në disa vende në veprën e tij. Ndryshoi teknikë. U hodh me mani në një portretizim të padobishëm dhe të paqëllimtë, me temën e tij të vetme, model dhe objektiv të krijimtarisë së tij, atë grua fatkeqe. E vizatonte në qindra pozicione, shprehje, nuanca.

(E përktheu nga origjinali: **Iliaz Bobaj**).



Ledia Dushi lindi në Shkodër më 21.6.1978. Shkollën e mesme të Gjuhëve të Huaja “Shejnaze Juka”, dega anglisht e keu në vendlindje. Në vitin 2000 mbaron Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Dega Gjuhë-Letërsi. Nga janari i 2001 deri në qershor të këtij viti punoi si mësuese e letërsisë në shkollën e mesme të Përgjithëshme “Pjetër Meshkalla”, kurse nga janari i vitit 2002 e në vazhdim ishte drejtore e kulturës

dhe sportive, pranë Bashkisë Shkodër. Krahas punës dhe detyrave shtetërore, Ledia e apasionuar mbas letërsisë, shkruan dhe boton duke patur një shtrirje të gjërë të veprimtarisë letrare, gazetareske dhe në fushën e përkthimeve.

Autorja deri më tani botoi këto libra: “*Ave Maria bahet lot*” (1997) ku merr çmimin “Penda e argjendë”, akorduar nga Ministria e Kultures, Rinisë dhe sportive më 1998. Librin me poezi “*Seancë dimnash*” (1999), Askush nuk vdes për mue (poezi, 2003), *Vdekja m’shtihet burrë* (poazi, 2009), *Me mujt me fjet* (poezi, 2009) etj.

Ledia Dushi uke zotëruar mjaft mirë gjuhët italisht, anglisht dhe spanjisht ajo do ta drejtojë intuitën e saj poetike në një vizion për ta përsosur atë, në përkthime të disa autorëve të njohur si “*Pavdeksia dhe ligjërata të tjera*” – Jorge Luis Borges, esse filozofike, “*Arti i joshjes*” –Mauricio Calvesi, “*Poezia italyane e shekullit të XX*”-përkthyes e poetëve D’Annunzio e Palazeschi.

Ledia është bashkëpunëtoare me përkthime e punë origjinale në revistat letrare Mehr Licht e Aleph ; është autore e disa esseve në disa gazeta e revista për poezitë e Martin Camajit, Lazër Stanit, Luljeta Lleshanakut, Kalosh Çelikut, Skender Sherifit, Anton Çefës si dhe të prozave të Alban Balës, Nehas Sopajt, Pjetër Arbnorit. Është fituese e : Çmimit të parë në konkursin lokal “Migjeni -

1993, e Konkursit vjetor të gazetës “Zëri i Rinisë” për ciklin më të mirë në poezi -1996, e Çmimit “Penda e argjendë” për librin “*Ave Maria bahet lot*”, e Çmimit “Kalimera Poetike”-Ulqin 2000”. Është pjesmarrëse e edicionit të 39 -të të aktivitetit ndërkombëtar “Struga Poetry evenings”-2000, si dhe pjesmarrëse në javën e Letërsisë Shqipe në Salzburg, Maj 2003.

me mujt me fjet’ me kthimin
e pemëve t’mbytuna
e thirrrmat e mija shpendve
zotnuesa t’trishtimit t’paqiell
kasolle t’lëshueme e barka mejtimi
pluskojnë e cekin
flamë buzësh e kurrnga s’asht n’stinë...
me mujtë me kthimin e pemëve me fjetë
n’mos n’Shpirt Dimni diku asht

ky shpirt që zhgulet me u shlirue kocash
asht zogu që ndrin i qiellit ndër duer
e nata nata që bahet përshkënditëse
asht ferri i ndezun që na e ban mirë
koha asht e prekshme e matet me flutura
fryma e detit me krahë e shpend ikësa
flutura që enden e shkruhen mbi tokë
nuk kallëzojnë nuk heshtin veç dinë e vdesin
m’bahet se thonë asht i bukur prilli e maji
mandej ditët marrin frymë për ta e ndalen diku n`vjesht
ah për t`errëtin shpend që bart hjekë tue heshtë
vetë Deken pështjell me m`mbërritë

e di si kam me kenë e shtrime nën dhë
e verdhë si sendet që ndeshen për diell

kam me u zhgulë ma s`fundi me i gjetë
 Miqtë që kisha dashtë me i marrë n`grykë
 sa herë kisha dashtë me dashtë
 me u qasë t`papeshë si sendet e pezullta
 që i sillen luleve barit pemëve dritës
 Shpirt për Shpirt me u kundrue e mos me pasë t`ngime
 aromash e tingujsh e rrezesh e qiejsh t`papërshkuem
 me u amshue me u shelbue t`Përdritun t`Përdritun t`Përdritun
 Shpirt për Shpirt t`paterr t`patokë
 me Miq e Miq e Miq t`pamundun
 që kisha dashtë me i marrë n`grykë sa herë kisha dashtë me dashtë



***Hida Halimi pas pranimit të çmimit letrar: “RRAPI”, për
 veper jetësore nga Gani Xhafolli (2011).***



Mirela Sula Struga

lindi në Shkodër më 1975. Ka mbaruar studimet e larta për Gjuhë e Letërsi në Universitetin "Luigj Gurakuqi" në Shkodër. Studimet pasuniversitare i ka vazhduar në degën e Psikologjisë në Universitetin anglez "Sheffield". Tashti jeton dhe krijon në Tiranë. Mirela Sula ka bërë emër njohur në letrat shqipe jo vetëm si gazetare e analiste për

ngjarje e fenomene kulturore e sociale por sidomos është shquar si poetë e prozatore e suksesshme. Ajo është vlerësuar në konkurse kombëtare e ndërkombëtare, siç është ai "Libro Italiano 2001" në Itali, dhe "Ditët e verës 2002" në Elbasan për poezinë më të bukur. Po më shumë emrin e Mirela Sulës do ta hasim nëpër antologji poetike, libra kritikë dhe do ta gjejmë nëpër shumë manifestime të karakterit letrar duke depërtuar me mjaft sukses labirintheve të letërsisë. Autorja deri më tani ka botuar disa libra si: "*Leje për të jetuar*" - poezi (Tiranë, 1995), "*Te jetosh përgjysmë*" - prozë, (Tiranë, 1997), "*Elvana*" - prozë, (Tiranë, 1998), "*Ani Piterpani*" - poemë për fëmijë, (Tiranë, 2000), "*Fundjavë me Florën*" - poezi, (Tiranë, 2002), "*Atje vonon pranvera*" - poezi (Tetovë 2002) "*Hartat e dhimbjes*" - poezi, (Tetovë, 2003), si dhe është pjesëmarrëse në dy antologji: "*Syri i ujit*" i Strugës", (Strugë, 2003), dhe "*Horizonti*" (Itali, 2003) apo në antologjitë e manifestimeve ndërkombëtare letrare "*Hapa nëpër natë*", Tetovë 2003, "*Stili 97*", Shkup 2002 etj

Dashuritë i mbron Zoti!

Ora 00: e diela e mbyti të shtunën
mua më mbyt heshtja jote,
ndëshkoi veten me pritje dhe dëshirë për të besuar
Ti je fikur!
Ore kur të gjithë shuhen në vete
ndërsa unë
i bëj hije shpirtit tënd
pa të prekur
ende nuk më ke dhënë leje qëndrim aty
mirazh i mesnates luan me pasionin tim
jam zgjidhur nga fije iluzionesh
natën, shpirtit nuk i vë kufij.

Marramenthi çdo ditë ndalem
heshtur,
Në udhën e mendimeve që më çojnë tek ti.
Kryqëzuar prej frikës mbetur kam e ngalet.
Tepër vonë për t'u rikthyer
atje ku s'mund të jem më, në dënim.
Kam ecur gjatë në pavetëdije
për të shpejtuar prej fatit, aftit tim.
Tani në grusht shtërngoj lutjet e mia të vogla,
Që një ditë era të m'i sjellë në tokën tënde,
miku im.

Prej tjetër bote, çuditshëm shfaqesh



Mariana Aleksandrova

lindi në qytetin Svilengrad, ndërsa jeton në qytetin Dupnicë - Bullgari. Është anëtare e Lidhjes së Shkrimtarëve të Bullgarisë. Ka të kryer Filologjinë ruse në Universitetin “Shën Klimenti i

Ohrit” në Sofje. Punon si profesoreshë e gjuhës ruse në gjimnaz, është përkthyes dhe redaktore e shumë publikimeve. Është autore e gjashtë përmbledhjeve poetike:

1. *Vetmia e shpërndarë* - 1994.
2. *Përqaqimet e kësaj bote* - 1997.
3. *Impresioni në të bardha* - 1997.
4. *Tentimi i heshtur* - 1999.
5. *Disekcioni i dhembjes* - 2002.
6. *Qielli për kthim* - 2006.

Ka gati për shtyp librin me titull “*Kur erërat çmenden*”. Mariana Aleksandrova është e përfshirë në më shumë se dhjetë antologji të poezisë bullgare, në shumë almanahë ballkanikë, në gjuhën shqipe, serbe dhe maqedone.

Ka fituar mbi dhjetë çmime kombëtare dhe ndërkombëtare. Ku vlen të përmendet çmimi “E përcolla Natën” - për lirikë dashurie - në “Takimet poetike nën Rrap”, në Shkup - 2005, si dhe çmimin e madh në konkursin evropjan për poezi në Qendrën evropjane për kulturë “Alldo Moro”, Leçe, Itali - 2007.

Marjana Aleksandrova është aktive në jetën kulturore dhe letrare në Bullgari. Në mënyrë të vazhdueshme krijon në shumë fusha të artit letrar.

HESHTËN TURRECËT

Atë natë

heshtën turrecët.

Hëna - dhelpër e vjetër -

lehte tallshëm
dhe ngjitej
në ëndrrën time të tmerrshme
si meduzë.

Yjet
u shndërruan në pëshpëritje
në gotën e xhamtë të qiellit.

Heshtja
ra në akorde blu.
Dhe ngjyra ngriu
në xhama.

Në pragun tim
trokiti vjeshta.

Përktheu: A. Abdullahu




Marina Mijakovska poete, prozaiste dhe kritike letrare. Doktore e shkencave filologjike. E cila ka diplomuar, magjistruar dhe doktoruar në Katedrën e Letërsisë të Përgjithshme dhe Komparative në Fakultetin Filologjik “Bllazhe Koneski”, në Shkup.

Mijakovska është autore e librave me poezi: *Shpirti nomad* (2010); *Kuferat* (2012); *Alkimia psikoanalitike e pasionit* (2013); *Tirkiz në verë* (2015); libri me prozë *Shtëpizat* (2014); librat eseistik *Polimeri zhanrovik: Sandëk dërëshkrimesh në përpjekje* (2016) dhe *Modele të identifikimit gjinor* (2018), si dhe librin për fëmijë *Këngë për fëmijë për vitin e ri* (2017).

OQEANI I GRAVE

Në ujë të vluar
 fjalësh
 lahet
 shpirti im.
 Heshtja flet!
 Çelësi ngec në vrimë.
 Kujdes!
 Britmë e çmendur, egërsisht
 nga ky trup femre
 refuzon të heshtë.

(Rikëndoi: Asdren Çeliku



Mirela Papuçiu – VRAMENDJE

Sytë e lodhur u ngjajnë gramafoneve
me pllaka të thyera a hedhura
në ndërrim epokash, në kosh.
Muzika e tyre është një pentagram
i paluajtur,
si dashuri e marrë me mend.
Ti habitesh si karkasa jote
nga kuit një kujtesë mbërthyer
lakimit joshës të hijeve,
bën muzikë në frekuenca të ulëta,
por ja, dikush e dëgjoka!
Dikush e dëgjon e të tregon.



Natasha Lako (1948). Lindi në Korçë. Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa studimet universitare në Fakultetin e Shkencave Politike në Universitetin e Tiranës. Shkrimtare e letrave dhe e kinemasë ka shkruar dhe botuar:

Vëllime poetike: *Marsi Brenda nesh* (1972), *E para fjalë e botës* (1980), *Yllësia e fjalëve* (1986, çmimi

Migjeni), *Këmisha e pranverës* (1989), *Natyrë e qetë* (1990), *Thesi me pëllumba* (1995), *Këmbë e duar* (1998) etj. **Romane:** *Stinët e jetës* (1976) **Skenare:** *Mësonjtorja*, 1979 (çmimi i për skenarë), *Një emër midis njerëzve* (1983), *Fjalë pa fund* (1984), *I paharruari* (1985), *Muri i gjallë* (1989), *Fletë të bardha* (1990).

Ka bashkëpunuar për përgaditjen e skenarit: *Plumba perandorit*.

LETRA IME

Pa Tiranën prapa, pa Tomorrin, pa Korabin.
letra ime e nisur i ngjan një arkivoli,
që s'do të hyjë ndonjëherë në tokë.

Nuk ka vdekur njeri,
vetëm një letër.



Nehas Sopaj Lindi më 19. 07. 1954 në Sllupçan të Kumanovës. Filloren e kru në Opajë, të mesmen në Kumanovë, kurse studimet, gjuhë dhe letërsi shqipe në Shkup. Studimet pasdiplomike (dy vite) i kryen në Prishtinë, kurse magjistraturën e mbron më 1983. Doktoranturën me titull “Rrëfimi në romanin monologjik shqiptar” e nis në Prishtinë dhe e mbron në Shkup, më 1994. Duke filluar nga viti 1977, punon në gazetën Flaka si përkthyes, ndërkaq duke filluar nga nëntori i vitit 1979, punon në katedrën e Albanologjisë në Shkup.

Autori deri më tani botoi këta libra:

Këngët e blerta, poezi (1973}, *Algje*, poezi (1973), *Të fala prej hënës*, poezi (1975), *Në rreth*, poezi (1979), *Gjysmëhëna*, poezi (1980), *Gjëmat e gjëmisë*, prozë, (1985), *Letër Lirijes*, prozë (1987), *Himeret e harbuara*, poezi, (1988), *Në fund të Akeronit*, prozë (1993), *Panoramë e letërsisë shqipe për fëmijë* (prezentim antologjik), Gj. Fishta, N. Nikaj, E Mekuli, I Kadare, R. Hoxha, B.Dedja, R.Kukaj, Y. Shkreli, K.Çeliku, A.Islami, (1993-1994), *Lulet e verdha*, poezi (1996), *Çapini*, dramë-groteskë, Jehona, 1996, nr. 2-3, *Rrëfimi në romanin shqiptar*, studim letrar (1996), *Fluturimi mbi Sllupçan*, roman për fëmijë (1997), *Paralelet letrare* (dy studime: Purolirika shqipe dhe Rrëfimi në romanin shqiptar (1998), *Rruga e gaforres*, roman, (2000), *Letërsia për fëmijë* (tekst universitar), (2000), *Alga e dalë nga deti* (2001), *Antologjia e poezisë së pastër shqipe*, (prezentim antologjik - 24 autorë me parathënie), (2002), *Unaza e humbur*, roman (2003), *Energjia negative* (Novela ose kallëzime lirike); poezi, prozë, dramë dhe intervistë (2006), *Alga e dalë nga deti*, zgjedhje (2008), *Shpalimi i herbariumit* (studime letrare (2008), *Individualitete letrare I - Beqir Musliu* (studim) (2008) etj.

JAM DEHUR

jam dehur tapë dhe këmbët e mia
në shtëpi s'më shpiejnë
as sonte as nesër as kurrë

në shtëpi arrin
vetëm zëri im
i vonuar

jam dehur dhe bërë tape e koka ime
në shtëpi s'arrin por atje shkojnë
tri gra

në shtëpinë time arrijnë tri gra
dhe treqind rrëfime të rrejshme
për zërin tim të vonuar

oh nënë jam bërë t'më qash për turp
sonte kur dhembja jote e prët dorën time
dhe dashurinë për të vërtetën

në shtëpi s'arrin asgjë
ose të gjitha arrijnë
vonë pa mua



Gjon Gjergjaj, Pano Taçi, Iliaz Bobaj, Etleva Tafa dhe Delvina Kërluku, në Shkup.



Pandeli Koçi (Sazan

Goliku) Shkollën fillore, tetëvjeçare dhe të mesme i mbaroi në Vlorë. Është diplomuar në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, dega e gjuhë-letërsisë. Ka kryer disa specializime në fushën e gazetarisë dhe botimeve. Ka punuar mësues, punonjës kulture, gazetar si dhe redaktor

letrar në SHB “Naim Frashëri” e gjetkë. Që nga viti 1970 është marrë aktivisht me botimin e letërsisë shqiptare të botuar në Kosovë dhe ka qenë ligjërues i këtij krahu të letërsisë shqiptare në UT. Nga viti 1981 - 2002 ka punuar në sektorin e shtypit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Ka shkruar dhe vazhdon të shkruajë e botojë poezi, prozë, në organe të ndryshme letrare, sidomos në revistën "*Krahu i shqiponjës*". Shkruan edhe letërsi për fëmijë dhe tekste këngësh. Është marrë me kritikë letrare, recensione dhe ese. Është fitues i disa çmimeve kombëtare dhe vendore.

Veprat: “*Im bir Artani*”, poezi, 1982, “*Aventurat e lirisë*”, tregime, 1995, “*Epidemi kozmike*”, poezi, 1996, “*Ëndërr dashurie*”, poezi, 1996, “*Komitët e Malit të Bardhë*”, roman, 1999, “*Petalet e rëna*”, poezi, 2001, “*Aventurat e një mëngjesi*”, poemë, 2002, “*Trekëndëshi i qiellit të zi*”, tregime, 2006, “*Turbull*”, poezi, 2007 etj.

“*Korb, o korb!*”

“*Jam pëllumb, më tha,*

brengat më kanë nxirë”.

*Pema e tharë
mbushur me korba -
lulëzim i vdekjes.*


*Sqepi i korbit
çukit gjarprin e ngordhur
dhe gjarpri... u ringjall.*

*Korbi i ri këndoi...
Zëri i doli bilbilçe,
korbat e tjerë e shqyen.*

*Shqiponja në qiell,
korbi ha krimba në arë,
vezët i ha gjarpri.*

*Vetëm mbi borë
korbat e gërricin qartë
historinë e tyre.*

*Me pendën e korbit
preka katër horizontet
dhe natë - gjithkund.*



Prend Buzhala lindi më 1 nëntor 1951 në fshatin Çabiq të Klinës. Shkollën fillore e kreu në Ujëmirë, gjimnazin në Klinë, kurse fakultetin Filosofik, Dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, në Prishtinë ku ndoqi edhe studimet pasuniversitare për letërsi. Emër tashmë i njohur në letrat shqipe, si poet, publicist, romansier, tregimtar e kritik letrar, mund të konsiderohet ndër të

paktët autorë shqiptarë të suksesshëm dhe të vlerësuar në vitet e '90-ta. Edhe pse ka dyzet vjet, që ai intensivisht shkruan, përkundër vështirësive që i janë paraqitur gjatë rrugës së tij krijuese, sepse një kohë ishte i anatemuar dhe mohuar nga ish-ideologjia e së kaluar ekstreme, mirëpo, i nisur në rrugën që i kishte përcaktuar vetes, të poetit, prozatorit e të studiuesit, respekton procesin e tij krijues, që nënkupton edhe individualitetin e tij. Parimi i tij ishte: vrojto e bluaj. E kuptonte se nga ajo bluarje lind tharmi, lindin esencat, ndërsa periudha e inkubimit, e parapërgatitjes, ishte i vetëdijshëm se do të zgjatë. Krijimet që i nxori në dritë ky poet, siç shprehet edhe vetë ai, “u takojnë kohëve të ndryshme e rrethanave të ndryshme, janë shkruar në kohë të ndryshme dhe botuar në kohë të ndryshme, ose janë refuzuar për botim për shkaqe politike e jo letrare”. Edhe prangat, edhe grilat e burgut, edhe shumë pengesa tjera të mëvonshme, frymëzimin e tij prej poeti nuk patën mundësi t’ia prangosin. Të hulumtosh në botën krijuese të Buzhalës, në perceptimin intelektual për misterin poetik dhe botën jashtë tyre, edhe në të kaluarën, edhe në kohën që jetojmë, është një kërkim që ia vlen të jetë publik.

Buzhala, deri me tash në botën letrare përveç shumë libra të zhanreve të ndryshme, si me kritika, publicistikë, prozë etj., mirëpo

ai ka botuar edhe tre libra me poezi, të titulluar, “*O amë, o amë*” (1995), “*Për kë bie kabanë e re*”(1998), “*Shtatë seanca pranë Apokalipsit*” (1998), etj.

EDHE DHEMBJA DEHET ME BUKURINË E ÇMALLJEVE

Mesdita e mashtruar kotet,
Si bari kur e miklojnë erërat e jugut
E edhe ti kotesh
Me ylber të fikur në zemër.

Gyrët janë të besatuar
Si dielli me ditën
E edhe ti besatohesh me heshtjen
Në atë diell zumtie.

Shuhet malli i vashave
Kur u vinë të dashurit nga mërgimi
E dhembja jote shuhet
E dehet me bukurinë e çmalljeve.

(1970-1971)



Radije Hoxha - Dija lindi në Shkup. Shkollën fillore dhe të mesme (të mjeksisë, dega infermiere) i kreu në Shkup, Maqedoni. Studjoi mjeksinë në Universitetin e Prishtinës, në Kosovë. Ka diplomuar për Mjeksi Tradicionale Kineze, dega Akupresure dhe Tui-na masazh “Belladona bimed”, në Shkup, në klasën e prof. dr. Edvin Dervisevic (Bosna & Hercegovina). Në Prishtinë kreu shkollën Art of Living (ideator dhe udhëheqës i saj është Sri Sri Ravi Sankar, nga India), në klasën e mësueses

Snezana Nisevic (nga Kroacia). Ka punuar 7 vjet gazetare në Shkup (Maqedoni) dhe 3 vjet në radio IRIB në Teheran (Iran), redaksia e programit në gjuhën shqipe. Aktualisht jeton në Prishtinë, punon gazetare dhe moderatore e programeve të kulturës, në Radio Televizionin e Kosovës - Radio Kosova.

Veprimtaria letrare

Është anëtare e Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptarë në Maqedoni, anëtare e Haiku Klubit Shqiptar “Ha” në Tiranë dhe anëtare e Haiku Klubit Kroat “Karolina Rijeçka”. Ka marrë pjesë në shumë manifestime kulturore poetike, në Ballkan dhe në Azi. Poezitë e saj janë përkthyer në anglisht, maqedonisht, kroatisht, boshnjakisht, rumunisht dhe turqisht, ndërsa janë botuar në disa revista letrare në rajon. Ka botuar 4 libra me poezi dhe prozë: Libri i parë, me poezi, “Zoti më do natën” është botuar në Shkup, nga Shtëpia Gazetare Botuese “ASDRENI”, në vitin 1995. Libri i dytë, “Unë bëhem Ajo” (poezi) botuar poashtu në Shkup nga Shoqata e Shkrimtarëve Shqiptar, në vitin 1997. Ky libër, në atë vit, në Manifestimin Ndërkombëtar letrar - poetik “Ditet e Naimit” në

Tetovë, fitoi çmimin “Libri i Vitit”. Libri i tretë është romani “*Mosdija*”, botuar në vitin 2000 nga Shtëpia Botuese “Buzuku” në Prishtinë. Libri u shpërblye me botim. Libri i katërt është përmbledhja poetike “*Gjeniu pleqnon çmendinë time*”, botuar nga Shtëpia Gazetare Botuese “ASDRENI” në vitin 2005, në Shkup. Në manifestimin poetik “Ditet e poezise Korçare” në Shqipëri, ky liber fitoi “Çmimin e Kristaltë”. Dhe, librin e pestë *HA - HA* (haiku, 2016) SHGB “ASDRENI”, në Shkup.

Kam mundur

Kam mundur të kem lindur në Paris,
me Senën lezbike të puthem vajzërisht.
Të jem gruaja e shtatë e ndonjë sheiku barktrashë,
Që ditën Zotit, e natën Burrit i lutet,
për pak dashuri (një herë në javë).

Gjithçka kam mundur të bëhem:
zezake, e verdhë, xhuxhe, cigane, insekt,
burrë shteti, grua mileti “si Çiçolina”, prefekt, difekt,
sëmundje ngjitëse, lidhëse, pikëpyetje a pikëçuditëse.

Edhe Zotit kam mundur ti bëhem grua,
të shëtis sarajeve, aty ku askush s’mund të shkojë!
Të ngrej Kishë e Xhami
dhe fshehurazi të të mbaj peng
nën dry...
por...
Ja që rastësisht jam Dija
dhe s’di ç’të bëj me Ty...!



Rami Kamberi lindi më 3 qershor 1960, në fshatin Gajre të Tetovës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Tetovë. Studimet Universitare dhe pas universitare i mbaroi në Prishtinë, Fakulteti i Filologjisë - dega: Letërsi dhe Gjuhë Shqipe.

Është penë e njohur si në prozë, poezi, kritik dhe meta-kritik letrare dhe publicistikë.

Jeton dhe punon në Tetovë.

Unë dhe ti

Lirishtës së dashurisë
Tej e tej

Ti andej
Unë përkëtej
Shtatet rrëzuar

Puthjet
Mes epsheve hutuar
Zjarre bluajnë

Koha mbet e harruar
Mes buzëve kafshuar



Remzi Salihu lindi në Gajre të Tetovës. Shkollën fillore dhe të mesmen e kreu në Tetovë, kurse Fakultetin Filozofik - Dega e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe në Prishtinë. Pos poezisë shkruan

edhe kritikë dhe përkthen nga gjuha gjermane. Ka përkthyer poezi prej Erih Fridit, Paul Celanit, Roze Auslanderit, H. M. Ecenzenbergerit, Wolfgang Behlerit. Ulla Hanit, Myhael Krygerit si dhe studimin, *Mjeshtria e interpretimit* nga Emil Shteigeri, etj.

Në konkursin letrar „Goranova prolet, që mbahej në Zagreb, fitoi me librin *Fluturimi i largët* të cilin shpërblim e botoi Rilindja, 1987. Librin e dytë *Sheshi i shtrigave* e botoi më 1992, librin e tretë *Gjurmë malli* ia boti Flaka 1993, Ka qenë themelues i Grupit letrar në Tetovë dhe redaktor përgjegjës i revistës „Vlera”. Madje njëri ndër themeluesit e Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve në Zvicër, Një kohë ka qenë në kryesinë e Shoqatës së poetëve „Pro dichtung Ballada” etj. Me poezitë e tij ka fituar nëpër shumë konkurse të ndryshme letrare. Më 2007 Merr çmimin Akti i shpirtit për poezi motivuese nga Shoqata e artistëve „Pushkin”. Ka punuar disa vite në arsim. Një kohë të gjatë ka vepruar dhe punuar jashtë vendit, në Zvicër. Tani jeton si krijues i lirë në Tetovë.

VËRSHIM I NJE BISEDE RASTI

ti pret të na marr vërshimi përpara
e gjuha të notojë nën akull
kurse unë kërkoj nëpër këtë llavë të derdhur
çdo gjë të kapet për kodrën e shpresës
nëpër vullkanin e jetës së dramatizuar

thonjtë e çasteve ma përgjakin lëkurën
e ti smalton rrëshirë të zjarrtë rreth trupit
por vërshimi dashurisë na hynë thellë midis nesh
nëpër xhepa të shpuar të kohës
thellë nën lëkurë inventari drite
ku gjaku thith mbishkrime preventive
duke shpaluar të kaluarën brishtë
nga fërkimet e distancës shpirtërore
në labirynt ndjenjash të kallura
ku digjet fshehtësi anonime
midis anëve tona ethe virgjërie arnohen
mbi dallgë vërshimesh korube eshtrash
të lidhura në shtegtim të hapur klithjesh



Reshat Sahitaj ka lindur më 1952 në fshatin Sopijë të Therandës. Ka një veprimtari letrare, kulturore dhe atdhetare. Për shkaqe politike, autori që i detyruar të largohej më 1979 nga Kosova dhe të vendosej në Belgjikë. Në Bruksel ndjek studimet e gjuhës frenge dhe diplomon në Ecole Supérieur de l'Etat. Atje ishte ndër organizatorët e shumë demonstratave kundër terrorit serb në Kosovë. Me 1983 emërohet sekretar për marrëdhënie me jashtë në

Komitetin e Mbrojtjes së të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, me kryetar Enver Hadrin. Pas vrasjes së Enver Hadrit, vazhdon veprimtarinë politike në Byronë Informative të Republikës së Kosovës deri në përfundim të luftës në Kosovë. Ka dhënë një kontribut të çmuar në miratimin e të gjitha rezolutave për Kosovën në Parlamentin Europian që nga viti 1989 deri më 1998. Reshat Sahitaj ishte ndërmjetësues i kontaktëve të para diplomatike në mes të të gjithë personalitetëve kosovare në Parlamentin Europian, Senatin Belg, dhe NATO. Në verën e 1998, në lokalet e OKB-së në Gjenevë, Reshat Sahitaj në bashkëpunim me zonjën Anne Marie - Lizin, arriti të organizon konferencë për shtyp të UÇK-së, ku mori pjesë edhe Bardhyl Mahmuti.

Interpjetimet në teatër dhe film:

“*Sfinga e gjallë*”, në Regji të Sefo Beta Krasniqit, 1977

“*Vdekja e Gjergjezit*”, radiodramë për RTP, 1978.

“*Rropullari*”, film televiziv i RTP, 1978.

“*Prilli i thyer*”, film Frëngo-amerikan, Francë 1985.

“AD”, film në regji të Isa Qosjës, luajnë: Ilir Shaqiri, Reshat Arbana... 1997.

“Zemër e vetmuar”, serial televiziv TV21, 2004.

“Krim pa krisma”, film nga Halil Budakova 2006

Libra të botuara:

“Rojtari i Shqipërisë së harruar”- tregime-1982.

“Rruga pa kthim” – roman- 1983

“Mali i ndaluar”- roman- 2003

“Ëndrra e nuses”- tregime - 2004

“Jeta e dyfishtë”- roman - 2005

“Kullerat”, komedi 2007

“Bashkëshortët”, komedi 2008

Që nga qershori i vitit 1999, jeton në Prishtinë.

Autor i emisionit letrar “Labirintet e fjalës” në RTK- 2006

Merret me shkrime publicistike, analiza, film, teatër; në “Koha ditore”, “Epoka e re”, “Kosova sot”, “Lajmi” etj.

GJAKU TE RRAPI

(Fragment nga romanu: Rruga pa kthim)

Bora, që kishte rënë tërë natën, kishte zbardhur fshatin. Frynte një veri i ftohtë. Rrugës kryesore dukej një rrah i ngushtë, që ishte çelur nga nxënësit e shkollës. Shumica e fshatarëve rrinin të mbyllur në shtëpi. Pakkush dilte për të shijuar bukurinë e fshatit të veshur në të bardhë. Disa nxirrnin vetëm kokën në dritare dhe shpejt afroreshin pranë stufës.

Bardhi nuk ishte nga ata që mund të qëndronte mbyllur. Mbathi çorapët e leshta e opingat, vuri xhurdinë e gunën

krahëve dhe çau borën. Ecte përmes rrugës, që dilte nga fshati për në thellësi të fushave. Shikonte përtokë, duke patur kujdes të mos rrëzohej. Diçka i vlonte përbrenda dhe ndiente nevojë të ecte fillikat. Shtëpitë përdhese të fshatit dukeshin më të bukura nën borën, që kishte mbuluar myshqet e çative. Pasi kaloi shtëpinë e fundit të fshatit, ngadalësoi hapin, rregulloi gunën dhe ndezi një cigare.

Kur iu afrua shkollës, dalloi nipin e tij, Gurin, në mesin e fëmijëve në oborr. Ata loznin sikur të mos nirthnin fare. Loja dhe të qeshurat e vocrrakëve i jepnin gjallëri fshatit. Plaku ua kthente përshëndetjet, duke bërë me dorë. Pranë dyerve të shkollës dalloi mësuesin Fadil Saranxha, nga i cili shmangu shikimin. Fëmijët e fshatit mësonin në këtë shkollë vetëm deri në klasën e katërt. Për të pestën e më tej duhej të vazhdonin në Therandë. Fshatarët kërkonin të hapeshin edhe klasat e tjera, por nga lart u vinte kërcënimi se mund t'ua mbyllnin edhe atë që kishin.

Fusha shtrihej menjëherë pas shkollës. Ai ndieua lodhje, por nuk donte të pushonte. Kapërceu rrugën që shpinte në Prizren, nga dukej kroi i Beqir Halitit dhe rrapi shekullor. U ndal para kroit, ku verës vashat mbushin kënatat për punëtorët në ara. E soditi kroin gjatë thujse nuk do ta shihte kurrë më. Bëri dy hapa në drejtim të rrapit dhe u ndal para tij. I dukej shumë më i moçëm se ai vetë. Veriu shungëllonte degët e tij, por ai qëndronte i fortë. Uji rridhte nga çepi në lugun e çimentos, që Beqiri e kishte mbaruar para pak vitesh, rrëshqiste në vijën e hollë dhe zhdukej nën akull.



Rexhep Bajrami

lindi në fshatin Çelik të Karadkut të Gjilanit. Shkollën fillore e kreu në fshatin Pidiq të Karadkut të Gjilanit dhe në Hasanbeg të Shkupit. Gjimnazin, Akademinë Pedagogjike dhe Fakultetin Filologjik - Dega Gjuhë dhe Letërsi

Shqipe i kreu në Shkup. Autori deri më tani botoi këta libra: *Nata tek unë të harroi*, poezi (1998), *Kur të kthehesh merre diellin*, poezi (2003) dhe *Thashë: është Hënë*, poezi (2009).

Në gur e shkruajta emrin t'im

Emrin e shkruar në gur lumi ta gjeta
Aty kishe lënë mërzinë
E ditëve që kalove në vetmi
Erdha pas gjurmëve të tua
Më zuri edhe mua melenkolia
Çfarë e keqe të paska gjetur
Në gur e shkruajta edhe unë emrin t'im
Shoqëri t'i bëjë vetmisë



Skënder Rusi ka lindur më 15.07.1952 dhe ka kryer studimet e larta për gjuhë - letërsi në vitet 1971-1975. Në vitin 1984 ka diplomuar për dramaturgji dhe në vitin 1998 për drejtues biblioteke në Kajro. Pas kthimit në Shqipëri ka punuar si mësues letërsie. Që nga viti 1986 ka qënë drejtor i Pallatit të Kulturës “V. Mio” në Korçë e që nga viti 1992

vazhdon të jetë drejtor i bibliotekës “Thimi Mitko”, Korçë. Skënder Rusi ka botuar 8 libra me poezi dhe dy nga dramat e tia janë vënë në skenë nga trupa e teatrit “A. Z. Çajupi”. Me njërën prej dramave ka marrë edhe çmim kombëtar. Po kështu poezitë e tia janë vlerësuar e nderuar me çmime të para si në shkallë kombëtare ashtu dhe ballkanike. Ka publikuar krijime në gazeta , revista e antologji në disa vende të Europës si në Gjermani, Zvicër, Maqedoni, Kosovë, Greqi etj. Dymbëdhjetë vjetë me radhë është kryetar i Klubit të Shkrimtarëve “Bota e Re”, në Korçë. Redaktor dhe botues i 120 librave në poezi e prozë të krijuesve të rinj dhe me përvojë në krijimtari. Shtatë vite me radhë organizon dhe drejton aktivitetin më të madh kulturor në Korçë: “ *Netët korçare të poezisë* ” me poetë të ftuar nga Kosova, Greqia, Maqedonia, Turqia, Bullgaria, Rumania, Italia etj.

Autori deri më tani ka botuar këta libra: *I njomë ishte bari*, poezi (1974), *Lirikë* (1982), *E paske një mall*, poezi (1987), *Dhe vjen një moshë*, poezi (2000), *Simfonia e takeve*, poezi (...), *Se ti gjithmonë seç bën ca gjëra*, poezi (2004), *Ç'ditë e bukur për të vdekur*, poezi (2005), *Duhet të duhemi*, poezi, *Digjen meteorë*, përzgjedhje (2008) etj.

Kryqëzimi

Te lutem hiqe këmishën vishnje të buzëve
Që të të ndjej kur të të puth!

Kush kryqezohet me poetin
O bëhet Krisht,
O bëhet shkrumb!

Të lutem hiqe najlonin roze të natës,
Që mes nesh mos ketë asgjë pa shpirt!

Kush kryqezohet me poetin
O bëhet shkrumb,
O bëhet Krisht!

Të lutem, erdhi çasti të shuash qirinjtë.
U ndezën zemrat. Mjaft tani!

Kush kryqëzohet me poetin,
O bëhet Krisht,
O bëhet hi!!!



Seida Beganoviç

lindi në vitin 1961, në Zenicë Bosnjë. Studimet e filozofisë dhe sociologjisë i kreu në Sarajevë.. I ka ndërrua shpesh vendbanimet dhe vendet e punës. Vitet e fundit u është përkushtuar shkrimeve të tregimeve të shkurtëra, poezisë dhe rrëfimeve për fëmijë.

Autorja deri më tani ka botuar këta libra: *Indeksi i foljeve*, poezi (2005), *Shkundja e shpuzores*, poezi (2006), *Kufijt*, poezi (2008)

Intervistë me shtëpinë e kaltërt, roman (2007) etj.

ZGJIMI

Endërra imiton shakullinën
Ikin zgjimet nga shtrati.
Dhe përse të ngrihem.

Dhe të vij. E paftuar!
Do ta pres. Nuk do të vijë!
Po, derën nuk do t'ia hapë.
Askujt dera nuk i hapet.

Ani, le të heshtë edhe më tej pas xhamit.
Do të fotografoj dritare në derë.

Ashtu si në vendin e murit të lagur.

E vendos karriken.

Dhe i shikon kalimtarët.

Do të jetë e menduar.

As kufjen nuk do ta ngrejë.

Do të lë porosi tek sekretarja. Heshtja.

Do të lajmërohet një herë.

Nuk do të përgjigjet.

As ajo nuk do t'i përgjigjet.

Kurrë nuk u përgjigjet porosive.

Ani le të heshtë edhe më tutje pas xhamit.

Atij të fotografuarit.

Edhe atij tjetrit që do të fotografohet.

Në këndin e murit të lagur.

Ëndërra imiton shakullinën

Ikin zgjimet nga shtrati.

Rikëndoi nga origjinali:

K . ÇELIKU



Sabile Keçmezi – Basha

lindi në Koretin të Dardanës (Kamenicë). Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse gjimnazin në Dardanë. Është femra e parë nga Kosova që mbaroi Fakultetin e Shkencave Politike në Beograd më 1977. Studimet pasuniversitare i vazhdoi në Universitetin e Prishtinës në Degën e Historisë. Magjistroi më 1980 dhe doktoroi më 1984 (ishte femra më e re që u bë doktore e shkencave në Kosovë).

Është anëtare e Kryesisë së Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Në vitin 2001-2004 ishte deputete e Parlamentit të Kosovës. Aktualisht merret me probleme të historiko-politike të kohës më të re. Sabile Keçmezi-Basha është anëtare e Akademisë Evropiane të Arteve e cila është themeluar në vitin 2002, me seli në Luksemburg.

Që nga viti 1978 punon në Institutin e Historisë të Kosovës dhe ka titullin e këshilltarit shkencor.

Gjer më tani ka botuar këta libra:

Botime shkencore: Programet politike të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare 1878-1990, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2013, Veprimtaria atdhetare ilegale në Anamoravë 1945-1968, I. Instituti i Historisë, Prishtinë, 2013, Shtypi ilegal shqiptar në Kosovë (1945-1999), I”, Prishtinë, 2009, Organizatat dhe grupet ilegale në Kosovë 1981-1989”, Prishtinë 2003 etj.

Botime letrare: *Këmisha e atdheut*, (poezi), MKRS, Prishtinë, 2013, *Nata pa kornizë* (roman), Prishtinë, LSHK, 2008, *Malli për Itakën* (poezi), Prishtinë, LSHK, 2008, *Hadi* (dramë), Prishtinë, LSHK, 2005, *Dy lule ka mami* (poezi), Prishtinë, “Pionieri”, 1993, *Nusja e gurtë* (poezi), Prishtinë “Rilindja”, 1989 etj.

NUSJA E GURTË

TË MË GJEJË NË NJË PËRRALLË

Në urë duvaku i nusërisë
Ç'kumbon e trazon botën
Shekujt sfiduan njëri-tjetrin
Në urë duvaku i nusërisë
Fëmija qumësht kërkon në vaj
Urata e ktheu prapë në legjendë
Të na gjejë prapë në një përrallë
Zogu thirri tri herë emrin e nuses
Ajo prapë në urë mur
E nuhati si lulen në legjendë
Ku mbeti duvaku i nusërisë

Për fëmijën që s' diti ç' është çudia
U rrokullisë nëpër djep e zbriti
Në qemerin e urës e pa të ëmën
Dhe tha :”Lëreni aty ku është
Ajo prej aty më jep gji amshimi”

Zogu i zi doli nga guri akull
U fal tri herë dhe fluturoi pastaj
Të gjitha unë i pash, vaj-
Ura e Fshejtë më lulëzoi në dorë.



Sami Velçani poet i mirënjohur dhe avokat ,është një zë i veçantë plot muzikalitet, rimë dhe ritëm. Autori ka një vizion të vetin mbi realitetin. Poeti në poezinë e tij shpalos besimin se duhet gjithmonë të përballet me sakrificat të ndryshme me durim dhe urtësi. Herë- herë poeti magjepset dhe përbetohet pas idealeve të mëdha të cilave u thur vargje madhore.

Autori deri më tani botoi këto libra: *Rrëfimet e Bahçe Shpejtanit* (tregime), *Kënga e Arabasë së vjetër* (poezi), *Regëtima e gjethes*, *Deti i puthjeve*, *Tymjakët*, *Statuja e Atletit*, *Arusha e pajetës*, *Kontratë me ujkun*, *Ditari i së dielës* (poezi) etj.

Seicili ka një ditë si kjo imja

Vjeshta ime

Qiej të trazuar si krushq' të dehur
(Gjithë vjeshtët vijnë të sjellin erë)
Vërsulen mbi mua pa pandehur,
Ditlindjes sime pa pranverë.

Sot e doja të kthjellët mëngjesin,
Pa shtjella reshë gjithë hakërrim,
Por nga qiejt' litarë shiu po zbresin,
E mblidhen e mblidhen shpirtit tim.

Mëngjese të veshur me kostume shiu,
Dallgë reshë si lumi mbi copëz stralli,
Pak gas në shpirt më mbinë vetiu,
Përlotur nën jargavanë malli.

Seicili ka një ditë si kjo imja,
Ku para tij shfetoheh kalendarët,
E ndien gjoksin t'ja shtërngoj dhimbja,
Dhe se ndal dot të qarët.



Hida Halimi pas pranimit të çmimit letrar: “RRAPI”, për vepër jetësore nga Gani Xhafolli (2011).



Skënder Demolli

Skënder Demolli. -

Në ka një njeri që prodhon humor në rrethana tragjike është vetëm një, Skënder Demolli. E them, në rrethana tragjike, sepse ai është i zhytur me kokë e me këmbë në Shekullin 21 Shqiptar që është një shekull që ka filluar të shtojë Tragjedinë Shqiptare. Këtë humor ai na i sjell me anën e fabulave të tij të cilat

tallin alegorikisht tërë botën e mbrapësht shqiptare. Por ne jse, unë s'kam ndërmend të bëj një kritikë për veprën e tij, unë dua vetëm që të tregoj “rënjtë” e Skënder Demollit në mënyrë që dikush tjetër të zbulojë më tutje, trungun, degët dhe gjethet e tij.

Kreu me nota të shkëlqyera shkollën e mesme dhe po ashtu Institutin e Lartë Bujqësor duke u bërë një agronom i talentuar por pa e braktisur talentin e tij të lindur, letërsinë. Nga fabulat, të cilat i mblodhi në disa libra si, “Në përralla dhe në jetë”, “Parlamenti i kërminjëve”, “Gomari padit të zotit”, Skenderi kaloi në komedi nga të cilat po përmënd, “E bukra ime”, “Shtëpia e ëndërrave”, “Arapi me trëndafila”, “Këpuca e Maros”, “Edhe një Don Zhuan”, etj.

Në rrugën e gjatë të krijimtarisë letare, pas botimeve të librave me fabula dhe poezi, romane, ai nis një udhë të re, atë të dramaturgjisë, s' hkruan drama dhe shumë shpejt afirmohet dhe bëhet një dramturg i sukseshëm. Këtë famë ia shtoi bashkëpunimi me artistin e madh korçar, Dhimitraq Orgocka, duke vënë në skenë dramën e tij dhe jashtë Shqipërisë, në skenat e teatrove të Maqedonisë, në Bitol, (Manastir), e gjetkë.

Për kënaqësin e lexusit po postojmë një fabul të shkurtër nga pena brilante e tij :

Gomari dhe Miza

*– Më lidhni në bisht një tullë , -tha gomari./ – T’u jap mizave një shpullë!.../ E në vend të vriste Ndonjë mizë, / e bëri copë kokën dhe kurrizë. /
Eh!...Mbetëm tërë jetën gomerë.../Veten tonë e vemë gjithmonë... /
Sa herë matemi me të tjerë...*

Duke biseduar këtu në Amerikë, me të vëllain, intelektualin, ish kolegun tim, Ilias Demollin, më del përperpara fytyra e tij modeste e çiltër, e më thotë:

-Mjaft, na thurre elozhe, nuk na shkojnë këto lajka, ne devollinje... -prandaj po e lë me kaq, portretin e tij të madh, por të njeriu të thjeshtë.

Skënderi ka qënë dhe ngelet një njeri shumë i dashur me të gjithë por veçanrisht me shokët, miqtë që e duan ashtu siç i do ai, një vëlla devolli dhekrenar.

Mirë u takofshimim në sofra miqësore letrare.

Luan Kalana



Sermet Sulejmani – publicist dhe poet, lindi më 11 prill 1963 në fsh. Llopat të Kumanovës. Shkollën fillore, të mesmën i kreu në Kumanovë, ndërkaq fakultetin për Gjuhë dhe letërsi shqipe në Prishtinë. Merret kryesisht me shkrime publicistike. Herë pas here shkruan edhe poezi patriotike - erotike. Ja disa:


UNË E TI DHE ATA

Unë dhe ti,
 si dje,
 si sot patëm ëndërr dhe lot ...
 një Atdhe,
 dhe një Zot!
 E ata?
 – Si dje si sot,
 S’kishin as lot as Zot,
 Ju bëj be, në Atdhe
 As sot, as dje,
 Në sy s’e patën
 Asnjë pikë lot!
 Unë e ti për be,
 që kur kemi le,
 ëndërr e kemi një
 Atdhe!
 Po Ata?
 Ata qenë hardhucë

Pilingucë
Denbabaden – atë!
Pa komb e pa fe,
Pushtet qenë. Pushtet i ke.
Fiqfiriq sot,
Vithkuqër – dje!



Samii Velçani duke rrëmbyer Çmimin letrar në Letërsi për fëmijë: “Mehmedali Hoxha”.



Visar Zhiti lindi më 2 dhjetor 1952 në Durrës dhe u rrit në Lushnjë, ku kreu edhe gjimnazin. Ka studiuar Gjuhë dhe Letërsi shqipe në Universitetin e Shkodrës e disa vite punoi në Kukës si mësues. Në vitin 1973

provon të botojë dorëshkrimin poetik *Rapsodia e jetës së trëndafilave*, botim që s'u jetësua dot, pasi dorëshkrimi interpretohet nga redaktorët e shtëpisë botuese shtetërore si "shtrembërim i realitetit socialist". Mjaftoi vetëm kaq, për ta dënuar pastaj më 1980 me 10 vite burg. Pas lirimit ka botuar disa vëllime poetike, ku mund të përmendim: *Kujtesa e ajrit* - Tiranë 1993, *Hedh një kafkë te këmbët tuaja* - Tiranë 1994, *Mbjellja e vetëtimitave* - Shkup 1994, *Dyert e gjalla* - Tiranë 1995, *Si shkohet në Kosovë* - Tiranë 2000. Poezitë e tij janë përkthyer në disa gjuhë të huaja.

Jetoj në syrin tënd

Siç duket
Unë jetoj brenda në syrin tënd.
Bashkohen qerpikët,
Vjen nata për mua,
E ngrohtë.

Gjumi im rrëzon rrobet si gjethet e mëdha.
Kur të treten, të mos të di gjë
Që jam ajo pemë në largësi.

Zogjtë ndërtuan një fole. Është zemra
Ime.
Pastaj dhe një zemër tjetër
Me fijeditë
Dhe me kokrriza dheu si dhimbjen
Te krahët e mi e ndërtuan zogjtë.
E dija
Është zemra jote.
E pashë
Kur hape sytë dhe solle agimin tim.

Kam kaq kohë që jetoj në syrin tënd,
Dhe që të shplodh,
Dal herë pas herë shetitje
Në formën e kulluar të lotëve



Vahit Nasufi lindi më 9 gusht 1945 në fshatin Veleshtë të Strugës, Maqedoni. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, Normalen dhe Shkollën e lartë Pedagogjike në Shkup. Me shkrime filloi që nga bankat e shkollës fillore. Shkruan kryesisht poezi dhe prozë për fëmijë. Vahit Nasufi jeton dhe punon në Veleshtë. Është anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Maqedonisë që nga viti 1983. Dhe, i Lidhjes së

Shkrimtarëve Shqiptar në Maqedoni.

Autori deri më tano botoi këta libra: *Valët e Drinit*, poezi (1980), *Dallëndyshja dhe lisi*, poezi (1984), *Kush ëndërron më bukur*, poezi (1985), *E kam shok bilbilin*, poezi (1987), *Koha e xixëllonjave*, poezi (1987), *Heshtja e gurit*, poezi (1994), *Gjyshja i numëron yjet*, poezi (1996), *Pesha e gurit*, poezi (1997), *Limalot*, poezi (1997), *Edhe pak Hënë mbi mal*, poezi (2005) etj.

Edhe pak Hënë mbi mal

Nuk është vetëm fjalë
nuk janë veç dy zanore.
dhe, tre bashtingllore
është diç më shumë.
Të rrish gjithë jetën në gjumë
natë e parë, natë e dytë
veç je humbur.
Mbytesh në detin blu
bëhesh shok i ëndrrës.
Dhe, nëse do të largohesh
ajo s'të lë të ikësh

s'iket prej vetvetes!
Nëse për një çast
ta zëmë se ti humbesh
atëherë më ti nuk ekziston
pra, ke vdekur i gjallë.
Më mirë që ke shok ëndrrën.
Është natë. Hëna të përcjell
deri te lëndina mbi fshat.
Hëna, ti dhe yjet.
Edhe pak Hënë mbi mal...



**Poetët në vendlindjen e Xha Derallës (Cërvicë – Kërçovë)
me një Orë përkujtimore poetike për satiristin e madh...**



Vanghea Mihanj – Steryou lindi në Dolani, Shtip (1950). Poete, prozatore, përkthyesë, piktore, aktore dhe realizatore vllëhe. Kryetare e Shoqatës të Shkrimtarëve dhe Artistëve vllëh në Maqedoni. Autore e rreth 40 librave në poezi e prozë. Organizatore e disa festivaleve ndërkombëtar të poezisë dhe simpoziume të letërsisë dhe kulturës. Edhe kryeredaktore e disa

revistave letrare në gjuhën rumune. Autorja deri më tani botoi këto libra: *Lule* (poezi), *Dallëndyshja* (1, 2 dhe 3, poezi për fëmijë), *Dashuri e pafund* (poezi), *Kurora e dashurisë* (poezi), *Laramanja* (poezi për fëmijë), *Bontoni për fëmijë* (1,2 dhe 3), *Ylli me çerdhe* (poezi për fëmijë), *Syri i shpirtit* (poezi), *Qiell pa yje* (poezi), *Vllehet e bukura* (roman), *Shtëpi pa shkallë* (roman), *Numratorët e gjyshit* (roman), *Edhe drerët qajnë* (roman) etj.

POPULLI IM (Poezi 1)

(Poezia është shpërblyer me 3 Çmime ndërkombëtare).

I mjegulluar në errësirën e ëndrrës që pushton
 Ngecur në kurthën e kohës
 I robëruar në dritën e tempujve
 Të ndalur në rrugën ku nuk kalojnë shekujt,
 Populli im!
 I shpërngulur nëpër botën e luleve
 Mes intervaleve të kohës që heshtë
 I shikuar në orbitën e dhëmbjes,

I Nemur në jehonën e gurit dhe pshertimave,

Populli im!

Me qetësimin e dridhjeve të gjoksit

Si yll është me shkëlqim të vjeshtës

Nga thellësitë e oqeanit,

Më thërrasin!

T'ua hap dyert etjeve të rrufeve,

Rrugë t'u hap të parëve.

Populliim!

Në tancin e primitivizmit të forografisë harruar

I shikuar, i çuditshëm, nuk është më!

I gurosur si një embrion i përjetshëm.

O. sa me kranri këndo

Për rrugën dhe vajin e popullit tim...

POPULLI IM / 2

Populli im i gurosur

I shikuar në buzëqeshjen e humbur

të diellit.

Memec në strehën e ëndrrës heshtjes!

Me zhurmën e ngarkuar të pamjes vetmuar.

Me dritare të mbyllur në zemër dhe shpirt,

Pa zogj t'i këndojnë,

Në parzmoren e turpshme ofshamë,

Memec...

Populli im!

Sikur vdes para agimit...
I Them! – Zgjohu!
Ne jemi fati me shenjë,
Me rrënjë të thella në lule!
Ja! Unë edhe sonte do të të këndo
Për kohën koprrace të shekujvve,
Për rrënjët që i ujit toka.
Rrënjët që lahen në burimin e shekujve
Sot, të zhveshur, si imbyturi në hurdhë
Me dhimbje të gërçi që guros thirrin:

Hey! Popull!
Heu! Ju të përvuajturit, karavanxhi,
Zogjë shtegtar nëpër botë.
Të shpërnguluar nga vatrë. Zgjohuni!
Drita dhe rrënjët – Rrënjët dhe drita!
Ato janë: - Ardhmëria...
Një tjetër heshtje
e frenon ofshamën e dhimbjes.
Populli im! – Me shikim në perëndim.

(Rikëndo nga maqedonishtja: K. Çeliku)



Xhevahir Spahiu lindi në Malind të Skraparit më 1 mars 1945. Mësimet e para i mori në Vlorë, ndërsa studimet e larta i kreu në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin Histori-Filologji, dega e Gjuhë-Letërsisë shqipe. Prej vitit 1968 punoi si gazetar në gazetën "Zëri i Popullit" më pas në revistën libretist në Teatrin e Operas dhe retar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe a prej shkurtit të vitit 1998 - 2000, kryetar i Lidhjes. Nga veprat e tij të botuara përmenden: "Mëngjes sirenash" (1970); "Vdekje perëndive" (1977); "Agime shqiptare" (1981); "Nesër jam aty" (1987), i vlerësuar me çmimin "Migjeni"; "Heshtje s'ka" (1989), fitues i çmimit të parë në konkursin e 45-vjetorit të Çlirimit të Atdheut; "Ferrëparajsa" (1996) etj.

Rekuiem për orën 6

Ora 6

Akrepat si dy krahë të hapur që presin
dhe ti s'po vjen

ti s'po vjen as në 6 e një minutë

në 6 e dy minuta vetmia ish me mua

unë isha me vetminë në 6 e tre minuta

në 6 e katër bota ishte po ajo

6 e pesa i ngjante 6 e gjashtës si dy pika uji

6 e shtatë, 6 e tetë, 6 e nëntë, 6 e dhjetë

Ti s'po vjen

S'po vjen

S'vjen

në 6 e pesëmbdhjetë
hodha sytë si dy vetëtima në fushën e orës së qytetit
akrepat u thyen si dy krahë të një zogu
që s'ekziston

Unë mora pikëllimin për dore
dhe ika



**Hapja e ekspozitës figurative “Ballkanika” e piktorit të madh
kërçovar: Ramadan Ramadani - Ballazhi (2014), në Kërçovë.**



Xhelal Tosku lindi në Rogozhinë. Shkollën fillore dhe atë mesme i kreu në vendlindje. Studimet e larta në Elbasan. Autori deri më tani botoi këta libra: *Në stacionin e parë* (poezi), 1987, *Mos harro të vish* (poezi), 1991, *Trishtim i verbër* (poezi), 1996, *Qiparis në rrugë* (poezi), 2000 *Dhe asgjë më pastaj* (poezi), 2005.

LULESHITSJA DHE

PALMAT

Në dyqanin e madh të luleve
 Erdhën plot palma nga Karaibet,
 unë shkoja aty thuajse çdo ditë.
 Justifikimin e kisha gjetur, por luleshitsja
 s'deshi që s'deshi të bëjë dashuri me mua.
 Për inat të saj, pastaj unë fillova të pi
 dhe si për inat të saj, në ënderr
 Shihja vetëm palma.



Xhelal Ademi lindi në vitin 1964 në Zajaz të Kërçovës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Kërçovë. Studimet e larta, Gjuhë dhe Letërsi Shqipe në Prishtinë dhe Tetovë. Autori deri më tani botoi këta libra: *Ende kemi rrugë*, poezi (1995), *Mëkat nate*, poezi (1995), *Diell në Skëtërrë*, roman (1997), *Rrugë detrash* (2005), roman etj.

Ti mund të largohesh

Nëse mundesh të harrosh gjithçka tonën përmbi dhe Gjithçka bërë e sodite gjithçka preke gjithçka pe,
Madje hapit përmbas shpine nëse mundesh t'i vëshë emër
E t'i ndrydhish njëmijë heshtje që të ecin nëpër zemër.

Nëse mundesh t'i vëshë fshesën gjithçka ishte jeta jote
T'hedhish ndjenjën nëpër detra mes valnajës fuqiplote,
Nëse mundesh të rrëmbesh gjithçka tënden që më dhe
Dhe t'pështyshë nga ece dje për të hapur rrugë të re.

Nëse buzës i vë dryrin që t' mos shkrihet nëpër vaj
Gjitha puthjet t'ia shkëpusish mu aty tek cep i saj,
E t'i hedhish përmban qiellit o t'i djegish përmbi prush
Dhe e akullt t'i sodisish me atë sy të zi si rrush.

Nëse plagët mund t'i mbyllish t'arratisesh fare kot
Mbi karvanët e kujtesës mos ia beh ky qiell me lot,
Nëse mundesh t'mbyllish sytë nën qepalla kur të shkosh
Atëherë ndodh që të largohesh duke bartur shpirtin bosh...



Zejnure Salihu

lindi më 4 qershor 1964
në Kumanovë. Shkollën
fillore dhe të mesmen i
kreu në vendlindje.
Studimet në Shkup.
Sociologe e diplomuar.
Jeton dhe punon në
Kumanovë.

Autorja deri më tani botoi këta libra: *Mykja e mollëve*, poezi (1995), *Jo*, poezi (1997), *Dy Liza në një përrallë*, tregime për fëmijë (2001), etj.

VEND KAM EDHE PËR NJË DASHURI

Fare s'më ka marrë malli për ty
s'të urrej as s'të dashuroj
kam vend për një tjetër dashuri.
Po pres një ditë të bardhë
plot fat.

Jo. Burri i saj nuk do të më çmendë
më në shtrat...

Përmbajtja**Në vend të parathënies**

TË LEXOSH POEZI PRANË TANKEVE /1

1. Adem Xheladini / 7
2. Asdren Çeliku / 9
3. Behare Neziri / 11
4. Besnik Lena / 12
5. Beatriqe Balliqi / 13
6. Bujar Ganija Plloshtani/ 14
7. Baki Ymeri / 16
8. Bardhyl Londo / 18
9. Bardhyl Maliqi / 20
10. Çezar Rica / 23
11. De Mersman Patricia / 24
12. Demir Gjergji / 26
13. Delvina Kërluku / 28
14. Dashnor Selimi / 30
15. Dashamir Malo / 32
16. Dhimitër Pojanaku / 33
17. Etleva Tafa / 34
18. Entela Safeti Kasi / 35
19. Emin Mamudoski / 37
20. Fatime Kulli / 38
21. Fadil Curri / 39
22. Flora Brovina / 41
23. Fatmir Minguli / 43
24. Gjon Gjergjaj / 45
25. Irena Gjoni / 46
26. Iliaz Bobaj / 48
27. Kalosh Çeliku / 50
28. Kostas Valetas / 53
29. Ledia Dushi / 55

30. Mirela Sula Struga / 59
31. Mariana Aleksandrova / 61
32. Marina Mijakovska / 63
33. Mirelea Papuçiu / 64
34. Natasha Lako / 65
35. Nehas Sopaj / 66
36. Pandeli Koçi / 69
37. Prend Buzhala / 71
38. Radije Hoxha - Dija / 73
39. Rami Kamberi / 75
40. Remzi Salihu / 76
41. Reshat Sahitaj / 78
42. Rexhep Bajrami / 81
43. Skënder Rusi / 82
44. Seida Beganoviq / 84
45. Sabile Keçmezi – Basha / 86
46. Sami Velçani / 88
47. Skënder Demolli / 90
48. Sermet Sulejmani / 92
49. Visar Zhiti / 94
50. Vahit Nasufi / 96
51. Vanghea Mihanj Steryu / 98
52. Xhevahir Spahiu / 101
53. Xhelal Tosku / 103
54. Xhelal Ademi / 104
55. Zejnure Salihu / 105

LIDHJA DE SHKRIMTAREVE SHQIPTAR
TAKIME NËN RRAP 2020



Manifestimin Kulturor Tradisconal Takime nën Rrap, në kohë
pandemie Onlaine dhe për së gjalli në Shkup, e ndihmoi
materialisht edhe Ministria e Kulturës në Republikën Maqedonisë
Veriut.